



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 229 Akti

Nr. 212 Vendimi
Tiranë, më 22.11.2019

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Etleda Çiftja
Firdes Shuli
Roland Ilia

Kryesuese
Relatore
Anëtar

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Anisa Duka, në prani edhe të vëzhgueses ndërkombëtare znj. Elka Ermenkova, në datat 20.11.2019 dhe 22.11.2019, në Pallatin e Koncerteve, (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0, (underground), Tiranë, mori në shqyrtim në seancën dëgjimore publike çështjen që i përket :

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Z. Kleanth L. Zeka**, prokuror në Prokurorinë e Apelit Vlorë.

OBJEKTI: Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.

BAZA LIGJORE: **Nenet 179/b, A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, të ndryshuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”; **Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”; **Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”; **Ligji nr. 49/2012**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi relatimin dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Firdes Shuli, mori në shqyrtim shpjegimet e provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, përfundoi procesin e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, z. Kleanth Zeka, proces i cili ka përfshirë kontrollin dhe rivlerësimin e të tria kritereve: të pasurisë; të figurës; dhe të aftësisë profesionale, mbështetur në pikat 1 dhe 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, dhe në përfundim, pasi shqyrtoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT E ÇËSHTJES

1. Z. Kleanth Zeka është subjekti i rivlerësimit për shkak të funksionit të tij si prokuror në Prokurorinë e Apelit Vlorë dhe në bazë të pikës 3, të nenit 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016”), të gjithë prokurorët i nënshtrohen rivlerësimit, *ex officio*.

2. Subjekti i rivlerësimit, z. Kleanth Zeka, ushtron funksionin e prokurorit në Prokurorinë e Apelit Vlorë, që prej qershorit të vitit 2014 dhe aktualisht. Më herët, në periudhën dhjetor 1997 – qershor 2014, ka ushtruar detyrën si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë.

3. Me shkresën nr. *** prot., datë 17.5.2018, protokolluar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit, (në vijim Komisioni) me nr. ***, datë 22.5.2018, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), ka vënë në dispozicion aktin përfundimtar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit të rivlerësimit, z. Kleanth Zeka.

4. Me shkresën nr. *** prot., datë 2.11.2017, protokolluar në Komision, me nr. *** prot., datë 18.07.2019, Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK), ka vënë në dispozicion raportin mbi kontrollin e figurës, të deklasifikuar plotësisht me vendim e KDZH-së nr. ***, datë 18.7.2019, për subjektin e rivlerësimit, z. Kleanth Zeka.

5. Me shkresën nr. *** prot., datë 25.7.2019, protokolluar në Komision, me nr. *** prot., datë 30.7.2019, Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP), ka vënë në dispozicion raportin për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit, z. Kleanth Zeka.

6. Bazuar në pikën 2, të nenit 14, të ligjit nr. 84/2016, dhe në Rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit”, Komisioni, ka zhvilluar shortin në datën 15.11.2018, nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit, z. Kleanth Zeka, do t’i nënshtrohet procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues i përbërë nga komisionerët Etleda Çiftja Roland Ilia dhe Firdes Shuli. Relatore e çështjes u zgjodh me short komisionere Firdes Shuli.

7. Trupi gjykues, me fillimin e procesit të rivlerësimit, administroi:

- aktin për vlerësimin e pasurisë, sipas neneve 31 – 33, të ligjit nr. 84/2016, përpiluar nga ILDKPKI-ja;
- raportin e vlerësimit të figurës, sipas neneve 34 – 39, të ligjit nr. 84/2016, përpiluar nga DSIK-ja; dhe
- raportin e vlerësimit profesional, sipas neneve 40 – 44, të ligjit nr. 84/2016, përpiluar nga KLP-ja.

8. Me vendimin nr. 1, datë 26.11.2018, trupi gjykues vendosi të fillojë hetimin administrativ sipas nenit 45, të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit të subjektit, z. Kleanth Zeka, duke përfshirë të tria kriteret, atë të pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale, si dhe caktoi kryesuesin e trupit gjykues, komisioneren Etleda Çiftja. Të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit.

9. Me vendimin nr. 2, datë 25.10.2019, trupi gjykues vendosi:

- të përfundojë hetimin administrativ për të tria kriteret e parashikuara në pikën 1, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, kriterin e pasurisë, të figurës dhe të aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit;
- të miratojë rezultatet e hetimit administrativ;
- të njoftojë subjektin e rivlerësimit se provat e grumbulluara, kanë nivelin e provueshmërisë sipas nenit 45, të ligjit nr. 84/2016, duke i kaluar barrën e provës mbi rezultatet e hetimit, për të paraqitur prova dhe shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën, sipas parashikimeve të nenit 52, të ligjit nr. 84/2016;
- të njoftojë subjektin e rivlerësimit për të drejtat e tij në përputhje me nenin 47, të ligjit nr. 84/2016, për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenet 35 - 40 dhe 45 - 47 të Kodit të Procedurave Administrative;
- të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtën për t'u njohur me dosjen, të drejtën për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitareve, si dhe afatin brenda të cilit mund t'i ushtrojë këto të drejta.

10. Në datën 12.11.2019 subjekti vuri në dispozicion në rrugë elektronike parashitësë me sqarimet e tij dhe dokumente shkresore bashkëngjitur.

11. Me vendimin nr. 3, datë 18.11.2019, trupi gjykues vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit, z. Kleanth Zeka, në seancë dëgjimore në datën 20.11.2019, ora 10:30, pranë Pallatit të Koncerteve (ish Pallati i Kongreseve).

12. Në datën 20.11.2019 u zhvillua seanca dëgjimore për subjektin e rivlerësimit, z. Kleanth Zeka, sipas nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.

13. Në datën 22.11.2019, trupi gjykues pasi vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit, të deklarojë të mbyllur seancën dëgjimore, dhe bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, sipas të cilit: *“Komisioni dhe Kolegji i Apelimit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit, dhe vendimi merret bazuar në një ose disa prej kritereve, në vlerësimin e përgjithshëm të tri kritereve, ose në vlerësimin tërësor të procedurave”*, si dhe në pikën 6, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, shpalli vendimin për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Kleanth Zeka.

II. FAKTET DHE PROVAT MBI TË CILAT ËSHTË MARRË VENDIMI

II.1. RIVLERËSIMI I PASURISË

II.1.a. Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

Nga aktet e ILDKPKI-së rezulton se subjekti ka dorëzuar rregullisht deklaratat e interesave private për vitet 2003 - 2016, në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003 *”Për deklarinimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”*. Në datën 27.1.2017, subjekti ka dorëzuar *“Deklaratën e Pasurisë së Rivlerësimit Kalimtar, Vetting”* në ILDKPKI, në përputhje me nenin 32/1, të ligjit nr. 84/2016, *“Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”*.

Ky institucion ka kryer kontroll të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur, sipas neneve 30 – 33, të ligjit nr. 84/2016 dhe me aktin nr. *** prot, datë 17.05.2018, ka konkluduar se:

- *deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;*

- *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *nuk ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *nuk ka kryer deklaram të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.*

II.1.b. Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

Megjithëse sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror, referuar vendimit të Gjykatës Kushtetuese, Nr. 2/2017^[1] dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

Lidhur me pasuritë e subjektit të rivlerësimit, z. Kleanth Zeka, është kryer një proces i plotë dhe i mirëfilltë hetimi administrativ, sipas dispozitave ligjore të kreut VII të ligjit nr. 84/2016, bazuar në: (i) deklaramet e subjektit në ILDKPKI; (ii) provat shkresore të administruara nga ky institucion dhe raporti i dorëzuar në Komision; (iii) çdo dokument ligjor që përbën mjet prove ligjore të kërkuar nga Komisioni gjatë procesit të rivlerësimit sipas nenit 49, të ligjit nr. 84/2016; si dhe (iv) komunikimet me subjektin sipas nenit 46, të ligjit nr. 84/2016 dhe dispozitave përkatëse të Kodit të Procedurave Administrative.

Hetimi paraprak administrativ në lidhje me vlerësimin e pasurisë, konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklarameve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe shpenzimeve, me qëllim evidentimin ose jo të mungesës së burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin ose jo të fshehjes së pasurive; (iv) evidentimin e deklarameve të rreme; (v) nëse subjekti ndodhet në situatën e konfliktit të interesit, me qëllim verifikimin nëse subjekti ka bërë deklaramet të pamjaftueshme për kriterin e kontrollit të pasurisë, sipas parashikimit të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016, i cili i referohet nenit 33 të tij.

Hetimi administrativ nga Komisioni, sipas neneve 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84 /2016, është kryer në lidhje me pasuritë e deklaruara nga subjekti, si vijojnë:

1. Apartament banimi me sip. 100.8 m², ndodhur në lagjen “****”, pallati “****”, kati ***, Vlorë, blerë në vitin 2015, sipas kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 12.8.2015. Vlera: 37 000 euro. Pjesa takuese: 100 %. Burimi i krijimit: kursimet ndër vite nga paga e subjektit dhe bashkëshortes së tij.

Në lidhje me këtë pasuri, gjatë hetimit administrativ, ka rezultuar se:

^[1] “41.Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas nenit 179/b, pika 5, të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: “Komisioni dhe Kolegji i Apelitimit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryhen vetë Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se “procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelitimit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se: “në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

- Agjencia Shtetërore e Kadastrës Vlorë¹ konfirmon të regjistruar në bashkëpronësi në emër të shtetasve Kleanth Zeka dhe V.Z., pasurinë e llojit apartament, me sip. 100.8 m², z.k. ***, vol. ***, f. ***, me nr. pasurie ***.

- OSHEE-ja² informoi se shtetasja V.Z. është abonente dhe ka kontratë të furnizimit me energji elektrike me nr. *** në instancën Vlorë, duke vënë në dispozicion informacion të plotë, i cili përputhet me deklaratimet e subjektit³.

1.1 Kjo pasuri është deklaruar nga subjekti, si vijon:

a. Në deklaratën periodike për vitin 2014: lidhje kontrate shitblerje sendi të ardhshëm (apartament banimi). Në rubrikën “vlera dhe shifra”, janë deklaruar shumat e kësteve të paguara prej 27 000 euro dhe 4 000 euro. Nuk është deklaruar burimi i krijimit.

b. Në deklaratën periodike për vitin 2015: lidhje kontratë shitblerjeje apartamenti me nr. ***, datë 12.8.2015, në shumën 37 000 euro. Në rubrikën “vlera dhe shifra”, është deklaruar pagesë kësti për blerje apartamenti, 2 000 euro dhe 4 000 euro. Nuk është deklaruar burimi i krijimit.

c. Në deklaratën “Vetting” si në pikën 1 më sipër.

Lidhur me mosdeklarimin e burimit të pagesave të kësteve në deklaratat periodike për vitet 2014 dhe 2015, subjektit i është kërkuar të japë sqarime. Në parashtrimet e tij por edhe në seancën dëgjimore, subjekti ka deklaruar se nuk ka qenë shumë i qartë në plotësimin e deklaratës, duke sqaruar se ka qenë një harresë e tij, nisur nga fakti se për sa kohë nuk ka pasur burim të ardhurash të tjera përveç atyre të deklaruara, automatikisht burimi i krijimit do të ishin këto të ardhura.

Në zbatim të nenit 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, i ndryshuar, subjektet mbartin detyrimin edhe për deklarimin e burimit të krijimit të pasurive. Mospërmbushja e këtij detyrimi ligjor, i bën deklaratimet periodike për vitet 2014 dhe 2015 të pasakta. Por, duke mbajtur në konsideratë: (i) faktin që në këto deklarime subjekti ka deklaruar saktësisht pagesat e kësteve; (ii) faktin që gjatë procesit të rivlerësimit nuk rezultuan burime të tjera të ardhurash të padeklaruara nga subjekti; (iii) faktin që në deklaratën “Vetting” është deklaruar dhe është vërtetuar burimi i krijimit të pasurisë me kursime ndër vite dhe me të ardhurat nga pagat e bashkëshorteve Zeka, Komisioni çmoi se pasaktësia në deklaratat periodike vjetore për vitet 2014 dhe 2015, për shkak të mosdeklarimit të burimit të krijimit të kësteve të paguara, nuk ka sjelle asnjë pasojë, dhe si rrjedhim nuk është konsideruar si shkak për penalizim të subjektit.

1.2 Në lidhje me origjinën e pronës dhe krijimin e pasurisë:

Nga aktet në dosje⁴ pasi janë konfirmuar në rend kronologjik veprimet si vijojnë, nuk janë konstatuar problematika dhe nuk ka pasur dyshime në lidhje me origjinën e pronës dhe krijimin e pasurisë:

¹ Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. ***prot., datë 19.8.2019, nga ASHK-ja Vlorë, në dosjen e Komisionit.

² Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. ***prot., datë 31.1.2019, nga OSHEE-ja, në dosjen e Komisionit.

³ Shihni e-mail dërguar nga subjekti në datën 21.1.2019, në përgjigje të pyetësorit të I-rë, në dosjen e Komisionit.

⁴ Shihni aneksin nr. ***, në dosjen e ILDKPKI-së dhe dokumentet bashkangjitur përgjigjeve të pyetësorit nr. 2, protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 22.7.2019, në dosjen e Komisionit.

- a.** Sipas certifikatës për vërtetim pronësie lëshuar në datën 24.10.2007 nga ZVRPP-ja Vlorë, rezulton se z. E. C. ka pasur në pronësi truall me sip 317 m², nga i cili sip. 234 m² është ndërtesë, me nr. pasurie ***, në z.k. ***, në lagjen *****, Vlorë.
- b.** Me kontratë sipërmarrjeje për ndërtim objekti shumëkatësh nr. ***, datë 15.1.2011, shtetasit E.C. dhe K.C. në cilësinë e pronarëve të truallit, kanë porositur ndërtimin e një objekti 10-katësh, me një kat parkimi nën tokë, në lagjen *****, nga investitori shoqëria ***** shpk, në sipërfaqen e truallit 317 m², dhe ndërtesës me sip. 234 m². Sipas kësaj kontrate raportet midis pronarit dhe sipërmarrësit do të jenë në vlerat 32 % të sipërfaqes së ndërtimit për pronarin dhe 68 % për sipërmarrësin, në gjithë sipërfaqen e ndërtimit.
- c.** Me aktmarrëveshjen nr. ***, datë 6.4.2012, midis pronarëve të truallit E.C. dhe K.C. dhe subjektit ndërtues ***** sh.p.k., janë përcaktuar pjesët takuese të pronarit dhe janë shprehur konkretisht apartamentet, njësitë e shërbimit dhe sipërfaqet e parkimit.
- d.** Me kontratë shitblerjeje sendi të ardhshëm nr. ***, datë 3.6.2014, blerësit Kleanthi Zeka dhe V. Z. kanë porositur të shitësit (pronarë truall) E. C. dhe K. C., apartamentin nr. ***, me sip 109.5 m², tipi 2+1, nga e cila sipërfaqe e përbashkët është 10.5 m², kati i 3-të, me çmim 37 000 euro. Sipas kësaj kontrate, çmimi i shitjes do të likuidohet, si vijon: (i) kësti i parë në shumën 27 000 euro është likuiduar sot në datën e lidhjes së kontratës, konfirmuar me konfermat bankare pranë “Raiffeisen Bank” dhe “BKT”; (ii) kësti i dytë në shumën 5 000 euro do të likuidohet deri në 30 dhjetor 2014; (iii) kësti i tretë dhe përfundimtar në shumën 5 000 euro do të likuidohet kur palët të lidhin mes tyre aktin kontratë shitblerjeje, por jo më shpejt se 31.8.2015.
- e.** Me deklaratë noteriale për dorëzimin dhe marrjen në dorëzim të pjesës takuese të pronarit të truallit nr. ***, datë 17.9.2014, sipërmarrësi deklaron se ka përfunduar ndërtimi dhe pronarët e truallit marrin në administrim pasuritë e përcaktuara.
- f.** Me kontratë shkëmbimi nr. ***, datë 13.3.2015, midis palëve E. C. dhe K.C. në cilësinë e pronarëve të truallit, dhe shoqërisë ***** sh.p.k., në cilësinë e investitorit dhe sipërmarrësit, është shkëmbyer pasuria truall në pronësi të pronarit, me pasuritë në pronësi të sipërmarrësit : 7 apartamente, 1 njësi dhe 2 garazhe.
- g.** Me certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, lëshuar në datën 24.4.2015, rezulton se E. C. dhe K. C. kanë në pronësi me ½ pjesë takuese pasurinë e llojit apartament me nr. pasurie ***, me sip. 100.8 m².
- i.** Me kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 12.8.2015, shtetasit Kleanthi Zeka dhe V. Z. kanë blerë nga shtetasit E. C. dhe K. C., pasurinë nr. ***, në shumën 37 000 euro.
- j.** Me certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, datë 26.8.2015, shtetasit Kleanthi Zeka dhe V. Z., kanë të regjistruar në pronësi me nga ½ pjesë takuese, pasurinë e llojit apartament me nr. pasurie ***, me sip 100.8 m².

1.3. Në lidhje me likuidimin e çmimit të shitjes prej 37 000 euro:

Gjatë procesit të rivlerësimit u vërtetua se kjo shumë është likuiduar tërësisht në rrugë bankare nga subjekti i rivlerësimit, brenda afatit të përcaktuar në kontratën e shitblerjejes të sendit të ardhshëm nr. ***, datë 3.6.2014, të përshkruar në mënyrë kronologjike si vijon :

- a.** Me lidhjen e kontratës së sendit të ardhshëm, datë 3.6.2014, është likuiduar shuma prej 27 000 euro, e cila është siguruar në këtë mënyrë:
Në datën 2.6.2014, z. Kleanthi Zeka, ka tërhequr shumën prej 26 500 euro nga llogaria e tij në “Raiffeisen Bank”⁵, të cilën në datën 2.6.2014 e ka depozituar në “BKT”, dhe pasi ka shtuar një shumë prej 500 euro, shuma prej 27 000 euro ka kaluar në llogari të shitësve po në këtë datë me përshkrimin “këst apartamenti”⁶.

⁵ Shihni aktin tërheqjeje nga llogaria, me shkresën nr. ***prot., datë 25.1.2019 nga “Raiffeisen Bank”.

⁶ Shihni shkresën nr. ***prot., datë 29.1.2019, të “BKT”-së, në dosjen e Komisionit.

Këto transaksione janë raportuar nga “BKT”- ja dhe “Raiffeisen Bank” pranë DPPP-së⁷.

Në lidhje me mënyrën e krijimit të depozitës prej 26 500 euro në “Raiffeisen Bank” janë verifikuar gjendjet e llogarisë në fund të çdo viti duke filluar që nga viti 2008⁸, krijuar me të ardhura të ligjshme, si në tabelën më poshtë:

VITI	2008	2009	2010	2011	2012	2013	2014
Gjendje depozita në euro	1 533	4 000	10 000	15 000	19 000	24 034	26 500

b. Në datën 10.10.2014, z. Kleanthi Zeka ka derdhur⁹ *cash* shumën prej 4 000 euro në “BKT”, në emër të noteres I. B., me përshkrimin “këst apartamenti për K. dhe E. C.”.

c. Në datën 10.4.2015, z. Kleanthi Zeka ka derdhur¹⁰ *cash* shumën prej 2 000 euro, në BKT në emër të noteres I. B., me përshkrimin “këst apartamenti për K. dhe E. C.”.

d. Në datën 11.8.2015, z. Kleanthi Zeka ka derdhur¹¹ *cash* shumën prej 4 000 euro, në BKT në emër të noteres I. B., me përshkrimin “këst apartamenti për K. dhe E. C.”.

1.4 Në lidhje me mundësinë financiare për blerjen e pasurisë:

Si burim krijimi janë deklaruar kursimet ndër vite nga paga e subjektit dhe e bashkëshortes së tij. Për të verifikuar nëse subjekti ka pasur mundësi financiare për blerjen e kësaj pasurie është kryer analiza financiare, si në tabelën më poshtë:

Përshkrimi	2014	Deri më 11.8.2015
PASURI	1.850.270	76.508
Blerë apartament me sip. 100,8 m ² , lagja “****” në vlerën 37 000 euro	5.184.070	
SHTESA/PAKËSIMË LIKUIDITETE	-3.333.800	76.508
DETYRIME	840.660	-825.900
Detyrim ndaj ndërtuesit (6 000 euro)	840.660	-825.900
PASURI NETO	1.009.610	902.408
TE ARDHURA dokumentuar	2.113.582	1.302.822
Të ardhura nga paga subjekti	1.424.023	858.872
Të ardhura nga paga bashkëshortja	547.463	366.600
Të ardhura nga interesa bankare	1.696	0
Të ardhura nga qiraja	140.400	77.350
SHPENZIME	879.992	560.690
Shpenzime jetese	879.992	560.690
Analiza dokumentuar	223.980	-160.276

Nga kjo analizë financiare, është konstatuar një likuiditet me të ardhura të pajustificuara në shumën 160 276 lekë, i cili iu bë e njohur subjektit në rezultatet e hetimit. Lidhur me këtë konstatim, në parashtrimet e tij ashtu sikurse edhe gjatë seancës dëgjimore, subjekti pretendoi

⁷ Shihni shkresë kthim përgjigje nga DPPP-ja, në dosjen e Komisionit.

⁸ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 25.1.2019, të “Raiffeisen Bank”, në dosjen e Komisionit.

⁹ Shihni aktin “depozitim në *cash*”, të BKT-së, bashkëngjitur kontratës së shitblerjes së sendit të ardhshëm në dosjen e ILDKPKI-së.

¹⁰ Shihni aktin “depozitim në *cash*”, të BKT-së në aneksin ***, në dosjen e ILDKPKI-së.

¹¹ Shihni aktin “depozitim në *cash*”, të BKT-së në aneksin ***, në dosjen e ILDKPKI-së.

se në këtë periudhë ka bërë shpenzime të kufizuara, pasi ka pasur lehtësi në buxhetin e tij familjar për shkak të produkteve bujqësore dhe blegtoralë që merrte pa shpërblim nga prindërit e tij në fshatin *** të Vlorës, si djalë i vetëm, pasi motrat e tij ishin larguar. Duke sqaruar se këto kontribute në natyrë nuk mateshin në vlerë monetare, ai nuk ka qenë shumë i qartë se si mund të pasqyroheshin kursimet në *cash* të përfituara prej tyre në deklaratat periodike. Gjithashtu, subjekti pretendoi se të dhënat e marra nga INSTAT publikuar në faqen zyrtare për periudhën 2002 – 2012 për vendet bregdetare, paraqesin standarde më të ulëta nga jetesa në Tiranë, të cilave i është referuar Komisioni.

Për të vërtetuar pretendimet e tij, subjekti i rivlerësimit depozitoi provat,¹² si vijojnë:

- deklaratë noteriale të nënës së subjektit, znj. M. Z., nr. ***;
- deklaratë noteriale të bashkëshortes së subjektit, znj. V.Z., nr. ***;
- akt të marrjes së tokës në pronësi nga babai i subjektit në datën 9.4.2005;
- vërtetim, datë 1.11.2019, lëshuar nga Njësia Administrative Qendër Vlorë;
- certifikatë familjare lëshuar në datën 1.11.2019, e cila vërteton përbërjen familjare të babait të subjektit, z. L. R. Z. për vitet 1974-1978, ku pjesë e saj është subjekti i rivlerësimit, z. Kleanth Zeka dhe tri motrat e tij;
- raporti i ekspertit kontabël të licencuar (auditues ligjor) në datën 7.11.2019.

Pretendimet e subjektit, si dhe dokumentet që ai ka paraqitur gjatë procesit të rivlerësimit, lidhur me balancën negative prej 160 276 lekësh, nuk janë marrë në konsideratë nga Komisioni, për shkak se ato mbeten në nivel deklarativ, arsyetuar në mënyrë më të hollësishme më poshtë në këtë vendim.

1.5 Në lidhje me mundësinë e trajtimit preferencial për blerjen e pasurisë:

Në përfundim të procesit, Komisioni konstatoi se nuk ka asnjë të dhënë dhe provë, që të tregojë që subjekti i rivlerësimit është trajtuar në mënyrë preferenciale për blerjen e kësaj pasurie, për shkak të pozicionit të tij si prokuror, arsyetuar si vijon:

Referuar udhëzimit nr. 2, datë 6.8.2014, “Për miratimin e kostos mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave për vitin 2014”, vlera mesatare e shitblerjes së banesave në tregun e lirë për vitin 2014 në qytetin e Vlorës është 61 655 lekë/m². Nga llogaritja aritmetike, një apartament me sipërfaqe 100.8 m² në qytetin e Vlorës në vitin 2014 do të kushtonte 6 214 824 lekë, ose referuar kursit të këmbimit në euro për periudhën në fjalë (140.26), sipas Bankës së Shqipërisë është rreth 44 309 euro. Subjekti e ka blerë me çmim 51.430 lekë/m² ose 37 000 euro, pra, rreth 7 000 euro me pak se çmimi referencë. Ky fakt u konfirmua edhe me katër kontrata të ngjashme shitblerjeje të vitit 2015 të vëna në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit¹³, nga të cilat rezultoi se: (i) në asnjë rast shitja e pasurive nuk ishte bërë në të njëjtin çmim për m² dhe se (ii) subjekti e kishte blerë pasurinë në një çmim rreth 60 euro më pak për m², se kontrata me çmimin më të lirë.

Nisur nga konstatimi sa më sipër, për të parë nëse subjekti ishte favorizuar nga shitësi për blerjen e pasurisë, u kryen veprimet verifikuese si vijojnë:

a. Subjektit të rivlerësimit iu kërkuan sqarime, i cili si në shpjegimet e tij gjatë procesit të rivlerësimit, ashtu edhe pasi u njoh me rezultatet e hetimit sqaroi se në përcaktimin e çmimit

¹² Shihni dokumentet, bashkëngjitur shpjegimeve për rezultatet e hetimit dërguar nga subjekti në rrugë elektronike në datën 13.11.2019, në dosjen e Komisionit

¹³ Shihni kontratat e shitblerjes, bashkëngjitur përgjigjeve të pyetësorit nr. 3, në dosjen e Komisionit.

të shitjes ka pasur ndikim fakti që me familjen C., familja e tij ka pasur miqësi të vjetër, duke qenë se vinin nga i njëjti fshat, por edhe fakti se apartamenti i blerë ndodhej në një pozicion jo ndër më të mirët, në katet e poshtme të pallatit. Për të vërtetuar këto pretendime subjekti depozitoi:

- deklarata noteriale nr. ***, datë 5.11.2019, të shtetasit K. C., në të cilën ai konfirmon deklaratimet e subjektit;

- kopje të *ID-së* së shtetasit K. C., sipas të cilës vendlindja e tij është fshati ***, i cili është edhe fshati i origjinës së subjektit të rivlerësimit.¹⁴

b. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë dhe ajo e Apelit Vlorë¹⁵ konfirmoi se subjekti nuk ka pasur çështje në shqyrtim ku pjesëmarrës të kenë qenë shitësit e pasurisë K. dhe E. C.

c. Prokuroria për Krimet e Rënda¹⁶ konfirmoi se në emër të shtetasit K. L. C., nuk rezultoi të jetë regjistruar ndonjë procedim penal.

d. Prokuroria e Apelit Vlorë ka vënë në dispozicion¹⁷ katër deklarime të subjektit në të cilat ai ka deklaruar konfliktin e interesit me shitësin e pasurisë, z. K. C. dhe babanë e tij, z. L. C., për çështje penale që janë rregjistruar në ngarkim të tyre pranë organit të akuzës, në të cilat u konstatua se:

- dorëheqjet janë dhënë pas datës 12.8.2015, datë kur është lidhur kontrata përfundimtare e shitjes së pasurisë (konflikti i mundshëm i interesit është trajtuar më poshtë në këtë vendim, gjate vlerësimit të aftësive profesionale).

- deklarimi i konfliktit të interesit është bërë për shkak të njohjes së hershme të subjektit me këta shtetas.

Në përfundim të procesit, bazuar në provat si më sipër, Komisioni, përveçse nuk administroi asnjë të dhënë që subjekti të ketë përfituar në mënyrë preferenciale blerjen e pasurisë me një çmim më të ulët se çmimi i tregut për shkak të pozicionit të tij, i çmoi të besueshme pretendimet e subjektit, se kjo ka ndodhur për shkak të njohjeve të hershme me shitësin e pasurisë, z. K. C. dhe më babanë e tij, të vërtetuara edhe gjatë hetimit administrativ.

2. Njësi shërbimi me sip. 14 m², ndodhur në lagjen “****”, Vlorë, pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë, blerë me kontratën nr. ***, datë 14.11.2011. Vlera: 700 000 lekë. Pjesa takuese: 100 %. Burimi i deklaruar i krijimit: kursimet ndër vite nga paga e subjektit dhe e bashkëshortes.

Në lidhje me këtë pasuri, gjatë hetimit administrativ, ka rezultuar se:

- Agjencia Shtetërore e Kadastrës Vlorë¹⁸ konfirmon të regjistruar në emër të shtetasve K. Z. dhe V. Z. pasurinë e llojit “njësi” me sip. 14 m², me nr. ***, vol. ***, f. ***, z.k. ***.

- OSHEE-ja¹⁹ informon se në emër të shtetasit Kleanth Zeka në adresën lagjja “****” rezulton kontratë e furnizimit me energji me nr. ***, e cila është hapur në datën 28.10.2008.

¹⁴ Shihni certifikatën familjare të datës 1.11.2019, bashkangjitur me parashtrimet e datës 13.11.2019, në dosjen e Komisionit.

¹⁵ Shkresë nr. *** prot., datë 15.7.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; shkresë nr. *** prot., datë 15.7.2019, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Vlorë; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 15.7.2019, të Gjykatës së Apelit Vlorë; vërtetim negativ lëshuar nga drejtuesi i Prokurorisë Vlorë, bashkëngjitur përgjigjeve të pyetësorit nr. 2, në dosjen e Komisionit.

¹⁶ Shihni shkresën nr. ***prot., (D.B.), datë 17.9.2019, nga Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë.

¹⁷ Shihni, dokumentet bashkangjitur në përgjigjet e pyetësorit të dytë, në dosjen e Komisionit.

¹⁸ Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 3.9.2019, nga Agjencia Shtetërore e Kadastrës, Drejtoria Vendore Vlorë, bashkëngjitur përgjigjeve të pyetësorit nr. 4 dërguar në rrugë elektronike nga subjekti në datën 5.4.2019, në dosjen e Komisionit.

¹⁹ Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 31.1.2019, nga OSHEE-ja, në dosjen e Komisionit.

2.1 Kjo pasuri është deklaruar:

- a. Në deklarimin periodik për vitin 2011: njësi shërbimi e ndodhur në lagjen “****”, k. ***, njësia ***, e fituar mbi bazën e kursimeve familjare, me vlerë 700 000 lekë. Pjesa takuese: 100 %.
- b. Në deklaratën “Vetting” si në pikën 1 më sipër.

Nuk ka pasaktësi apo mospërputhje në deklarime.

2.3 Në lidhje me mënyrën e krijimit të pasurisë dhe origjinën e saj:

Në përfundim të procesit të rivlerësimit rezultoi se kjo pasuri është fituar në mënyrë të ligjshme nga subjekti dhe bashkëshortja e tij, e vërtetuar në mënyrë kronologjike me aktet²⁰ si vijojnë:

- a. Me certifikatë për vërtetim pronësie lëshuar nga ZVRPP-ja Vlorë, në datën 23.9.2009, rezulton se në emër të firmës “****” sh.p.k. është regjistruar pasuria e llojit njësi me sip. 14 m², me nr. pasurie ***.
- b. Me kontratë shitblerjeje nr. ***, datë 14.11.2011, shtetasit Kleanth Zeka dhe V. Z. kanë blerë nga shoqëria “****” sh.p.k. objektin njësi shërbimi, me nr. pasurie ***, me sip. 14 m² në qytetin e Vlorës, me çmim 700 000 lekë.
- c. Me certifikatë për vërtetim pronësie lëshuar nga ZVRPP-ja Vlorë në datën 5.1.2012, rezulton se në emër të shtetasve Kleanth Zeka dhe V. Z. është e regjistruar pasuria e llojit njësi me sip. 14 m², me nr. pasurie ***.

2.4. Në lidhje me mundësinë financiare të blerjes me të ardhura të ligjshme, me kursimet në vite si dhe me pagat e subjektit dhe të bashkëshortes, rezultoi se :

Sipas kontratës së shitblerjes nr. ***, datë 14.11.2011, çmimi i shitjes së pasurisë prej 700 000 lekësh, është likuiduar plotësisht prej blerësit jashtë zyrës noteriale, dhe si rrjedhim kjo shumë është përfshirë në analizën financiare si shpenzim për këtë vit.

Për të verifikuar nëse subjekti ka pasur mundësi financiare për blerjen e kësaj pasurie është kryer analiza financiare për vitin 2011, si në tabelën më poshtë:

Përshkrimi	14.11.2011
PASURI	1.445.430
Njësi shërbimi, me sip. 14 m ² , lagjja “****”, k. ***	700.000
SHTESA/PAKËSIME LIKUIDITETE	745.430
TË ARDHURA dokumentuar	1.493.336
Të ardhura nga paga subjekti	1.070.572
Të ardhura nga paga bashkëshortja	387.452
Të ardhura nga interesa bankare	35.312
SHPENZIME	533.490
Shpenzime jetese	478.170
Shpenzime udhëtimi	55.320
Analiza dokumentuar	-485.584

²⁰ Shihni, aktet në aneksin nr. ***, në dosjen e ILDKPKI-së.

Nga kjo analizë rezultoi se subjekti nuk ka pasur mundësi financiare për të paguar tërësisht çmimin e blerjes së pasurisë prej 700 000 lekësh, për shkak të një diference të pajustificuar me të ardhura të ligjshme në një shumë prej 485 584 lekësh.

Lidhur me këtë balancë negative, subjektit i kaloi barra e provës sipas nenit 53, të ligjit nr. 84.2016. Në ushtrim të kësaj të drejte, në parashtrimet e tij e në seancë dëgjimore, ashtu sikurse edhe gjatë procesit të rivlerësimit,²¹ subjekti pretendoi se:

Pagesa e njësisë në shumën 700 000 lekë nuk është bërë tërësisht në vitin 2011, por ai e ka likuiduar atë të ndarë në këste: shuma 300 000 lekë në vitin 2008; shuma 100 000 lekë në vitin 2009; dhe shuma 300 000 lekë në vitin 2011. Për të vërtetuar pretendimet e tij, subjekti i referohet informacionit të vënë në dispozicion nga OSHEE-ja,²² sipas së cilës kontrata është hapur në datën 28.10.2008, ndërsa shpenzimet e energjisë kanë filluar në datën 27.7.2009.

Në mbështetje të këtij pretendimi, subjekti ka depozituar tre deklarata noteriale në të cilat konfirmohen deklaratimet e tij, si vijojnë :

- deklaratë noteriale me nr. ***, datë 18.7.2019, të z. L. Gj., administrator i shoqërisë “****” sh.p.k.;
- deklaratë noteriale me nr. ***, datë 5.11.2019, të ish-kolegut prokuror, z. S. D.;
- deklaratë noteriale me nr. ***, datë 2.11.2019, të bashkëshortes V. Z.

Veç sa më sipër, subjekti ngriti pretendime në lidhje me (i) lehtësi në buxhetin e tij familjar për shkak të produkteve bujqësore dhe blegtoralë që merrte pa shpërblim nga prindërit e tij në fshatin *** të Vlorës, si dhe (ii) në lidhje me llogaritjen e shpenzimeve të jetesës, duke iu referuar të dhënave të marra nga INSTAT publikuar në faqen zyrtare për vitin 2002-2012 për vendet bregdetare, të cilat, sipas subjektit, paraqesin standarde më të ulëta jetese nga ato në Tiranë, të cilave i është referuar Komisioni.

Bazuar në pretendimet sa më sipër, sipas analizës financiare të paraqitur nga subjekti në raportin e ekspertit kontabël të datës 7.10.2019, diferenca e pajustificuar me të ardhura të ligjshme për vitin 2011, zbrit nga vlera 485 584 lekë e llogaritura nga Komisioni, në vlerën 85 584 lekë.

Arsyetim ligjor:

Në lidhje me pretendimin se pagesa e njësisë në shumën 700 000 lekë, është likuiduar prej subjektit e ndarë në tre vite: 300 000 lekë në vitin 2008; 100 000 lekë në vitin 2009; dhe 300 000 lekë në vitin 2011, Komisioni i vlerësoi si të pabazuar për shkak se:

- Kontrata e shitjes me nr. ***, datë 14.11.2011, e vetmja provë shkresore në kohë reale, përcakton në mënyrë të shprehur se: “*çmimi i është likuiduar plotësisht prej blerësit jashtë zyrës noteriale*”, pa u shprehur në lidhje me pagimin e kësteve sipas pretendimeve të subjektit, që nënkupton likuidimin e çmimit ditën e lidhjes së kontratës.
- Informacioni i marrë prej OSHEE-së, sipas të cilit kontrata e energjisë është lidhur në vitin 2008 dhe shpenzimet kanë filluar në vitin 2009, janë provë që vërtetojnë periudhën kur njësia është vënë në përdorim, dhe jo provë që vërteton pagimin e çmimit të blerjes sipas pretendimeve të subjektit.

²¹ Shihni, dokumentet bashkangjitur në përgjigjet e pyetësorit të dytë, në dosjen e Komisionit.

²² Shihni, shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 11.9.2019, të OSHEE-së, në dosjen e Komisionit.

- Në deklaratat periodike vjetore të cilat sipas parashikimit të pikës 5, të nenit 32, të ligjit nr. 84/2016, konsiderohen prova gjatë procesit të rivlerësimit të subjekteve, subjekti nuk ka deklaruar pagimin e kësteve, sipas deklarimeve gjatë procesit të rivlerësimit.

Në lidhje me pretendimet e përfitimit të prodhimeve bujqësore dhe blegtorale prej prindërve të tij, Komisioni çmoi se, është në traditën shqiptare ndihma ekonomike që kanë familjet banuese në qytet nga të afërm të tyre banues në fshat, e si rrjedhim nuk perjashtohet mundësia që subjekti të ketë pasur lehtësi në shpenzimet për jetesën e përditëshme. Por, duke qënë se nuk u disponua asnjë provë për të vërtetuar të ardhura të kësaj natyre, pretendimet e subjektit nuk u morrën në konsideratë, pasi ato mbeten në nivel deklarativ, dhe gjate analizes financiare është përdorur i njëjti standart i zbatueshëm për të gjithë subjektet e rivlerësimit, lidhur me shpenzimet e jetesës.

Në këto rrethana, në përfundim të procesit të rivlerësimit, Komisioni çmon se subjekti nuk ka pasur mundësi financiare për të paguar tërësisht shumën prej 700 000 lekësh për blerjen e pasurisë objekt shqyrtimi në vitin 2011, për shkak të një diference të pajustificuar me të ardhura të ligjshme në shumën prej 485 584 lekësh. Por, në vlerësimin tërësor të çështjes, bazuar në parimin e objektivitetit dhe proporcionalitetit, Komisioni çmon se ky likuiditet i pajustificuar, nuk mund të përbëjë shkak për marrjen e masës disiplinore për shkarkimin nga detyra të subjektit të rivlerësimit.

2.5 Në lidhje me trajtimin preferencial për blerjen e pasurisë:

Në përfundim të procesit, Komisioni konstatoi se nuk ka asnjë të dhënë dhe provë që të tregojë se subjekti i rivlerësimit është trajtuar në mënyrë preferenciale për blerjen e kësaj pasurie, për shkak të pozicionit të tij si prokuror, arsyetuar si vijon:

Referuar udhëzimit nr. 4, datë 23.11.2011, “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave nga Enti Kombëtar i Banesave për vitin 2011”,²³ vlera mesatare e shitblerjes së pasurive në tregun e lirë për vitin 2011 në qytetin e Vlorës është 60 298 lekë/m². Subjekti e ka blerë me çmim 50 000 lekë/m², pra, afërsisht 10 000 lekë/m² më lirë nga çmimi i referencës. Nga llogaritja aritmetike, një apartament me sip.14 m² në qytetin e Vlorës në vitin 2011 do të kushtonte 844 172 lekë, pra pasuria është blerë rreth 144 000 lekë më lirë referuar vlerës mesatare të shitblerjes së pasurive në tregun e lirë për qytetin e Vlorës.

Nisur nga konstatimi sa më sipër, për të parë nëse subjekti ishte favorizuar nga shitësat për blerjen e pasurisë, u kryen veprimet verifikuese si vijojnë:

a. Pasi iu kërkuan sqarime subjektit, me dërgimin e rezultateve të hetimit u administruan parashtrimet e datës 13.11.2019, në të cilat, ashtu si edhe në seancë dëgjimore, ai deklaroi se në fakt, ka negociuar me shitësat e pasurisë për çmimin e blerjes së pasurisë për shkak të (i) pozicionit jo të favorshëm të njësisë në katin e dytë të krahut fundor të objektit dhe në pjesën e pasme të tij; dhe (ii) për shkak të njohjeve që ka pasur me bashkëshorten e administratorit të shoqërisë “****” sh.p.k., znj. L. Gj., me të cilën kanë qënë kolege, pasi ajo ka ushtruar funksionin si prokurore në Vlorë, gjatë kohës kur ai kishte shprehur interes për blerjen e njësisë, pra, në vitin 2008. Por, ai pretendoi se nuk është trajtuar me çmim preferencial krahasuar me blerës të tjerë. Për të vërtetuar pretendimet e tij, subjekti ka vënë në dispozicion tre kontrata shitblerjeje për tre njësi të tjera të ndodhura në të njëjtin objekt²⁴, (një prej të cilëve ndodhet në katin e parë) në të cilat rezulton se shoqëria i ka shitur ato, me një çmim edhe më të ulët për

²³ Ambienti ndodhet në katin e dytë dhe për këtë arsye është trajtuar si banës.

²⁴ Shihni kontratat bashkangjitur parashtrimeve të datës 13.11.2019, në dosjen e Komisionit.

m², sesa çmimi me të cilin subjekti ka blerë njësinë (50 000 lekë/m²), përkatësisht në çmimet 41 436 lekë/m², 40 000 lekë/m² dhe 44 000 lekë/m².

b. Prokuroritë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë dhe të Apelit Vlorë kanë konfirmuar se²⁵ nuk rezulton që subjekti i rivlerësimit të ketë përfaqësuar akuzën në çështje ku palë pjesëmarrëse të ketë qenë shtetasi L. Gj., administrator i shoqërisë “****” sh.p.k.

Në përfundim të procesit të rivlerësimit Komisioni, çmoi se nuk ka asnjë të dhënë që të vërtetojë që subjekti të jetë trajtuar në mënyrë preferenciale për blerjen e njësisë, për shkak të ushtrimit të detyrës së tij si prokuror, dhe se blerja e njësisë në një çmim pak më të ulët referuar vlerës mesatare të shitblerjes së pasurive në tregun e lirë për qytetin e Vlorës, ka qenë për shkak të marrëveshjes me vullnet të lirë të palëve në kontratë.

2.6 Në lidhje me të ardhurat nga qiraja të kësaj pasurie:

a. Në deklaratën “Vetting, subjekti ka deklaruar të ardhura të përfituara nga qiradhënia e njësisë së shërbimit për periudhën 2013 – 2016, në shumën prej 624 000 lekë, bazuar në kontratën e qirasë nr. ***, datë 11.1.2013.

b. Në kontratën e qirasë me akt noterial të datës 11.1.2013,²⁶ rezulton se afati i kontratës është 5-vjeçar, duke filluar nga 11.1.2013 – 11.1.2018. Qiraja mujore është 13 000 lekë.

c. Të ardhurat nga qiraja janë deklaruar rregullisht në deklaratat periodike si vijon: për vitin 2013 në shumën 156 000 lekë; për vitin 2014 në shumën 156 000 lekë; për vitin 2015 në shumën 156 000 lekë; dhe për vitin 2016 në shumën 156. 000 lekë, shuma totale e të cilave, përputhet me deklaratën vetting.

d. Subjektit iu kërkua të sqarojë si është bërë pagesa e qirasë nga qiramarrësit, i cili ka deklaruar se:²⁷ “... të gjitha pagesat janë kryer me para cash në dorë. ..Në periudhën janar 2013 qershor 2015 njësia është administruar me qira nga shtetasi A. dhe A. S. Pasi këta shtetas janë larguar dhe kanë mbyllur aktivitetin privat, zyra është administruar me qira nga shtetasja A. D., me të cilën deklaroi se ka vijuar marrëdhëniet me të njëjtat kushte, nga qershori i vitit 2015, e aktualisht sipas kontratës së re të qiradhënies të lidhur në datë 21.02.2018....”

Për të vërtetuar pretendimet e tij subjekti ka vënë në dispozicion dy deklarata noteriale²⁸ të lëshuara nga shtetasi A. S. dhe A. D. të cilët konfirmojnë deklaratimet e subjektit.

e. Subjekti, në lidhje me pagimin e tatimit mbi qiranë, ka deklaruar se: “... nga përgjigja e kthyer me shkresën nr. *** prot., datë 17.7.2019, prej Drejtorisë Rajonale Tatimore Vlorë jam vënë në dijeni se as shtetasi A. S., i regjistruar si person fizik dhe as shtetasja A. S. Dh. nuk kanë paguar tatim në burim (tatim qiraje) për periudhën nga data 11.1.2013 dhe në vazhdim. Në lidhje me këtë fakt shpjegoj se një situatë e tillë është krijuar pasi, unë kam menduar se ky ishte një detyrim i palës qiramarrëse, dhe nuk kam pasur ndonjë sinjalizim apo njoftim zyrtar për shlyerjen e tij. Mbas kësaj kam filluar menjëherë procedurat për shlyerjen e detyrimit, pasi më parë të njoftohem për shumën që më duhet të paguaj...”

Për të vërtetuar këtë pretendim, subjekti vuri në dispozicion shkresën nr. ***, datë 4.9.2019, të DRT-së Vlorë²⁹, me të cilën vërtetohet se shuma totale e tatimit mbi qiranë për periudhën janar 2013 – janar 2018 është 102 700 lekë. Nga kjo shumë, pjesa prej 50 950 lekë është paguar nga

²⁵ Shkresë dërgim informacioni, nr. *** prot.,(P.H.), datë 15.7.2019, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; shkresë kthim përgjigjeje, nr. *** prot., datë 15.7.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë; shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 15.7.2019, të Gjykatës së Apelit Vlorë; si dhe vërtetimi negativ i Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, bashkëngjitur përgjigjeve të pyetësorit nr. 2, në dosjen e Komisionit.

²⁶ Shihni dokumentin bashkëlidhur shkresës, datë 22.7.2019, nga noterja J. B., në dosjen e Komisionit.

²⁷ Shihni përgjigjet e pyetësorit nr. 3 dërguar nga subjekti në rrugë elektronike në datën 6.8.2019, në dosjen e Komisionit.

²⁸ Shihni deklaratën noteriale nr. ***, datë 1.8.2019, të shtetasit A. S. dhe deklaratën noteriale me nr. ***, datë 5.8.2019, të shtetasës A. D., bashkëngjitur përgjigjeve të pyetësorit nr. 3, në dosjen e Komisionit.

²⁹ Shihni përgjigjet e pyetësorit nr. 4 dërguar nga subjekti në rrugë elektronike në datën 5.9.2019, në dosjen e Komisionit.

qiramarrësja A. D., e cila ka paguar çdo muaj tatimin mbi qiranë për periudhën prill 2015 – janar 2018 dhe në muajin korrik të vitit 2019, z. Kleanth Zeka, ka paguar diferencën në shumën prej 54 400 lekësh, që i përket të ardhurave të periudhës 2013–2015, si në këtë tabelë:

Vitet	2013	2014	2015	TOTALI
Të ardhurat për të cilat tatimi në burim është paguar në 2019	140 400	140 400	85 933	366 733

Nga të gjitha sa më sipër, në vlerësimin tërësor të rrethanave, Komisioni, çmoi të konsiderojë të ligjshme të ardhurat nga qiratë për periudhën 2013–2015, në shumën prej 366 733 lekësh, (tatimi për të cilat është paguar nga subjekti gjatë procesit të rivlerësimit), referuar fakteve si vijojnë:

- i) të ardhurat nga qiraja janë deklaruar saktësisht nga subjekti që në deklaratën periodike vjetore të vitit 2013 e në vijim, deklarime të cilat përputhen me deklaratën “Vetting”;
- ii) marrëdhënia juridike e qirasë vërtetohet me një kontratë noteriale të lidhur që në vitin 2013, me dy subjekte qiramarrëse, të cilët kanë qenë dhe janë persona fizikë të regjistruar në organet tatimore: A. S. me NIPT *** dhe A. D. me NIPT ***;
- iii) sipas ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, dhe në referencë të përgjigjes së Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve³⁰, duke qenë se qiramarrësi është person fizik, mban në burim (në momentin e pagesës) tatimin mbi qiranë dhe ka detyrimin ta paguajë atë në organin tatimor.
- iv) ligji nr. 9920, datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 114, parashikon pagimin e detyrimit tatimor jashtë afatit të caktuar me ligj, duke përcaktuar sanksionet përkatëse, ndërkohe që neni D i Aneksit të Kushtetutës, nuk e lidh pagimin e detyrimeve tatimore me ndonjë afat kohor të përcaktuar.

3. Ambient banimi me sip. 42 m², ndodhur në lagjen “****”, Vlorë, godina e e ish-hetuesisë së rrethit Vlorë, kati i tretë, strehuar sipas shkresës nr. ***, datë 8.10.1997, të Prokurorit të Përgjithshëm, si punonjës i Prokurorisë së Rrethit Vlorë, pa titull pronësie për të cilën janë shpenzuar rreth 400 000 lekë, vetëm për përshtatjen e ish-zyrave në ambient banimi.

Në lidhje me këtë pasuri, gjatë hetimit administrativ, ka rezultuar se:

- Agjencia Shtetërore e Kadastrës Vlorë³¹ nuk e konfirmon të regjistruar këtë pasuri në emër të subjektit dhe bashkëshortes së tij. Për këtë subjekti ka deklaruar se nuk kanë nisur asnjëherë procedurat ligjore të privatizimit të banesës, duke dhënë shpjegimet përkatëse.³²

- OSHEE-ja³³ informon se në emër të z. Kleanth Zeka në adresën lagjia “****” ka kontratë të furnizimit me energji me nr. ***, ku referuar informacionit mbi abonentin rezulton se ajo është hapur në datën 24.7.2002, që përputhet dhe me deklaratimet e subjektit.³⁴

3.1 Kjo pasuri është deklaruar saktësisht nga subjekti, si vijon:

³⁰ Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 14.5.2018, nga Drejtoria e Përgjithshme e tatimeve, në dosjen e Komisionit

³¹ Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 19.8.2019, nga ASHK-ja Vlorë, në dosjen e Komisionit.

³² Shihni përgjigjet e Pyetësorit nr. 4 dërguar në rrugë elektronike nga subjekti në datën 5.4.2019, në dosjen e Komisionit.

³³ Shihni shkresën kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 31.1.2019, nga OSHEE-ja, në dosjen e Komisionit.

³⁴ Shihni e-mail-in dërguar nga subjekti në datën 21.1.2019, në përgjigje të pyetësorit të I-rë, në dosjen e Komisionit.

- Në deklarinimin e parë për vitin 2003 është deklaruar “Banesë 1+1, e pahipotekuar, lagjja “***”, ish-godina e hetuesisë Vlorë. Burimi: sistemuar si i pastrehë në ambientet e ish-godina e hetuesisë së rrethit në vitin 1999.

- Në deklaratën “Vetting” si në pikën 3 më sipër.

3.2 Në lidhje me origjinën dhe mënyrën e fitimit të të drejtës së posedimit:

Me qëllim verifikimin e origjinës dhe mënyrës se si subjekti ka fituar të drejtën legjitime të përdorimit të ambientit, u administruan dokumentet e vëna në dispozicion nga ILDKPKI-ja,³⁵ si dhe deklarinimet dhe dokumentet e vëna në dispozicion nga subjekti i rivlerësimit³⁶ në rend kronologjik si vijojnë, nga verifikimi i të cilave, nuk rezultuan problematika.

a. Me shkresën nr. *** prot., datë 8.10.1997, të Prokurorisë së Përgjithshme drejtuar Bashkisë së Rrethit Vlorë dhe Prokurorisë së Rrethit Vlorë, ish-godina e Hetuesisë së Rrethit Vlorë, i është dhënë për strehim punonjësve të kësaj prokurorie B. M., A. Xh. etj.

b. Me vendimin nr. ***, datë 21.10.1998, “Për kalimin e objekteve ushtarake në fond banese”, Bashkia Vlorë, vendosi të kthejë në fond banese objektin e Ministrisë së Rendit Publik – ish-godina e Hetuesisë së Rrethit Vlorë, miratuar për banesë nga Prokuroria e Përgjithshme me shkresën nr. ***, datë 8.10.1997, si dhe Drejtoria Rajonale e Entit Kombëtar të Banesave Vlorë, të bëjë privatizimin e saj.

c. Me shkresën nr. *** prot., datë 23.12.1998, Prokuroria e Përgjithshme i kërkon Drejtorisë Rajonale të Entit Kombëtar të Banesave Vlorë, zbatimin e shkresës së mësipërme dhe privatizimin e pjesës së mbetur të ish-godinës së Hetuesisë së Rrethit Vlorë, në favor të punonjësve të saj A. R. dhe Kleanthi Zeka.

d. Në vijim, nuk ka rezultuar që të jetë privatizuar pasuria objekt shqyrtimi, sipas akteve normative të sipërpërmendura, dhe për këtë shkak u pyet subjekti i rivlerësimit i cili ka deklaruar se:³⁷ *“...ambienti i banimit që unë disponoj i ndodhur në lagjen “***” në godinën e ish-hetuesisë, kati i tretë, vijon ende të jetë i paprivatizuar dhe i paregjistruar pranë ZVRPP-së Vlorë, pasi unë nuk kam nisur ndonjëherë procedurat ligjore të privatizimit të banesës. Kjo edhe për faktin se pak kohë pasi isha sistemuar me banim në atë objekt, ish-kolegu Bujar Madani, me detyrë OPGJ në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Vlorë (i cili ishte sistemuar me herët aty dhe kishte përfunduar procedurat e privatizimit), por edhe ish-punonjësi i prokurorisë A. Xh., e vite me vonë edhe ish-kolegu tjetër A. R., kanë hyrë në konflikt gjyqësor me personin që kishte privatizuar dy katet e para të objektit, i cili pretendonte të drejtën e parablerjes dhe të privatizimit edhe të katit të tretë të objektit në favor të tij, si kat shtese i ndërtuar mbi objektin ekzistues, duke kundërshtuar gjyqësish privatizimin e kryer nga shtetasi B. M. Në rrethanat e mësipërme, në kushtet kur banorët e tjerë të godinës ishin në konflikt gjyqësor, në të cilin unë nuk jam përfshirë asnjëherë si palë në proces, dhe kur mbi ankesën e palës pretenduese për shkelje të procedurave të privatizimit të katit të tretë, ishte bërë i mundur fillimisht edhe anulimi i privatizimit dhe regjistrimit të pronës të kryer në favor të shtetasit B. M., për shkak të shkeljeve të konstatuara në procedurat përkatëse, unë nuk kam gjetur arsye ligjore për vijimin e procedurave të privatizimit të ambientit të sipërpërmendur, në të cilin isha vendosur për të banuar mbi bazën e shkresës së Prokurorit të Përgjithshëm... ”.*

Subjekti, për të mbështetur deklarinimet e tij, ka vënë në dispozicion dokumentet shkresorë si vijojnë:

³⁵ Shihni aneksin *** në dosjen e ILDLPKI-së.

³⁶ Shihni, përgjigjet e pyetësorit nr. 2, në dosjen e Komisionit.

³⁷ Shihni, përgjigjet e pyetësorit nr. 2, në dosjen e Komisionit.

- shkresë e Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik, Tregtisë dhe Sipërmarrjes drejtuar Bashkisë Vlorë dhe Entit Kombëtar të Banesave³⁸, e cila informon për revokimin e aktit nr. 1139, datë 3.2.2012, të ish-Ministrit të Ekonomisë dhe Energjetikës, me të cilin është miratuar privatizimi i pjesës së mbetur të ish-godinës së Hetuesisë Vlorë.

- relacion i datës 25.4.2014³⁹, i përpiluar nga Njësia e Kontrollit të Brendshëm dhe Antikorrupsionit në Kryeministri, në lidhje me kontrollin e ushtruar nga kjo zyrë për verifikimin e gjendjes juridike, problematikat e hasura, si dhe procedurat administrative e ligjore të kryera për privatizimin e ish-godinës së hetuesisë, ndërtuar mbi objektin dy katesh të ish-pronarit Shefqet Verlaci, kontroll ky i kryer mbi ankesën e shtetasit B. M., prokuror. Nga përmbajtja e këtij relacioni, rezulton se për këtë pasuri ka pasur një proces të gjatë gjyqësor mes pronarëve të ndërtesës dykatëshe dhe përdoruesve të saj, duke vijuar më tej mes pronarëve të godinës dhe familjes M., banorë të katit të 3-të, të cilët e kishin privatizuar banesën e tyre.

Pas shqyrtimit provave të administruara sa më sipër, për pasurinë objekt shqyrtimi, në përfundim të procesit të rivlerësimit, u vërtetua se:

(i) subjekti ka deklaruar në deklaratën periodike për vitin 2003 posedimin e kësaj pasurie, sipas parashikimit të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, dhe në deklaratat periodike për periudhën 2003 – 2014, e ka deklaruar pasurinë objekt shqyrtimi si adresë banimi e regjistruar në Gjendjen Civile.

(ii) subjekti e posedon këtë pasuri nëpërmjet një akti ligjor të një institucioni publik, siç është Prokuroria e Përgjithshme bazuar në VKM-në nr. 15, datë 3.4.1993, *“Për kalimin e objekteve të mjeteve kryesore të ndërmarrjeve dhe institucioneve shtetërore”*.

(iii) kjo pasuri nuk është privatizuar dhe as është regjistruar në regjistrat publikë në emër të subjektit, për shkak të pavarura prej tij.

(iv) deklaratimet e subjektit përputhen plotësisht me të gjitha dokumentet dhe provat e administruara gjatë procesit të rivlerësimit.

4. Autoveturë tip “Alfa Romeo”, prodhim i vitit 1999, blerë në maj 2012 me kursimet nga paga. Vlera: 1 500 euro. Pjesa takuese: 100 %.

Gjate hetimit administrativ rezultoi se DPSHTRR-ja⁴⁰ ka konfirmuar se në pronësi të shtetasës V. Z. rezulton i regjistruar automjeti me targa ***, tip “Alpha Romeo”, model 156.

4.1 Kjo pasuri është deklaruar:

- Në deklaratën periodike për vitin 2012, blerje autoveture për përdorim vetjak, në shumën 1500 euro, pa u deklaruar burimi.

- Në deklaratën “Vetting” si në pikën 4 më sipër.

Nisur nga parashikimi i nenit 4, i ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar, mosdeklarimi i burimit të krijimit të pasurisë, e bën deklarin për vitin 2012 të pasaktë, pasaktësi për të cilën në parashtrimet e tij por edhe në seancë dëgjimore, subjekti ka reflektuar duke e pranuar atë, pasi gabimisht ka menduar se fakti që nuk kishte të ardhura të tjera veç atyre të deklaruara në deklaratën periodike të pasurisë për vitin 2012, ka qenë i mjaftueshëm.

³⁸ Shihni, shkresën nr. *** prot., datë 27.5.2014, të MZHETS-së bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit nr. 2, në dosjen e Komisionit.

³⁹ Shihni relacionin mbi kontrollin e ushtruar mbi gjendjen juridike të ish-godinës së Hetuesisë Vlorë, bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit nr. 2, në dosjen e Komisionit.

⁴⁰ Shihni shkresë kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 25.1.2019, nga DPSHTRR-ja, në dosjen e Komisionit.

Në përfundim të procesit, nisur dhe nga analiza financiare ku rezultoi se blerja e autoveturës justifikohet me të ardhura të ligjshme, kjo pasaktësi në deklaram, e cila është pranuar nga subjekti si një pakujdesi gjatë plotësimit të formularit, nga ana e Komisionit çmohet si formale, e si e tillë, nuk ka sjellë asnjë pasojë.

4.2 Në lidhje me mënyrën e krijimit të pasurisë, rezultoi se:

- Në deklaratën me akt noterial⁴¹, shtetasja F. L. deklaron se automjetin tip “Alfa Romeo” ia ka shitur shtetasës V. Z. me çmimin 1 000 euro, në datën 1.5.2012, në Venezia, Itali.

-Me aktin “njoftim debitimi⁴²” në Raiffeisen Bank, të datës 28.5.2012, rezulton se automjeti është zhdoganuar në vlerën 52 000 lekë.

Duke qenë se mjeti është blerë për vlerën 1 000 euro, ndërkohe që deklarimi është bërë për vlerën 1 500 euro, u pyet subjekti, i cili sqaroi⁴³ se : “... këtë deklaram e ka bërë për të qenë sa më i saktë, duke përfshirë në edhe shpenzimet e kryera për zhdoganimin e mjetit në vlerën prej 52 000 lekë, si dhe ato për regjistrimin e tij për herë të parë në vlerën 11 460 lekë, të cilat i ka konvertuar në shumën prej rreth 500 euro....”

Për të vërtetuar këto pretendime subjekti ka vënë në dispozicion deklaratën doganore të datës 28.5.2012, njoftimin e debitimit të datës 28.5.2012 të “Raiffeisen Bank”, si dhe faturën tatimore të DPSHTRR-së të datës 30.5.2012.

Nga analiza financiare, si në tabelën më poshtë, rezulton se subjekti ka pasur mundësi financiare me të ardhura të ligjshme për të blerë, zhdoganuar dhe regjistruar mjetin në datën 28.5.2010.

Përshkrimi	Shuma në lekë
Të ardhura Kleanth Zeka deri më 28.5.2012	475.469
Të ardhura V. Z. deri më 28.5.2012	202.548
Të ardhura nga interesa bankare	31.974
TOTAL TË ARDHURA	709.991
Shtesa likuiditete	300.052
Shpenzime jetese	232.580
TOTAL PAKËSIME	532.632
DIFERENCA (MUNDESIA PER KURSIM)	177.359

5. Llogari rrjedhëse në lekë, hapur në datën 7.3.2001, në degën rajonale të “Raiffeisen Bank”, Vlorë, sipas gjendjes deri në datën 23.1.2017. Vlera: 1 000 708 lekë.

6. Llogari rrjedhëse në lekë, hapur në datën 1.3.2005 (llogaria e pagës) në “Raiffeisen Bank”, Vlorë, sipas gjendjes deri në datën 23.1.2017. Vlera: 214 001 lekë.

⁴¹ Shihni deklaratë e paraqitur e aktit noterial, bashkëngjitur shkresës kthim përgjigjeje nr. *** prot., datë 1.2.2019, të DPSHTRR-së në dosjen e Komisionit.

⁴² Shihni aktin njoftim debitimi në “Raiffeisen Bank”, bashkëngjitur shkresës kthim përgjigjeje nr. ***prot., datë 1.2.2019, të DPSHTRR-së, në dosjen e Komisionit.

⁴³ Shihni përgjigjet e pyetësorit nr. 2, në dosjen e Komisionit dhe dokumentat bashkëngjitur.

7. Llogari rrjedhëse në euro, hapur në datën 7.3.2011 në “Raiffeisen Bank”, Vlorë, sipas gjendjes deri në datën 23.1.2017. Vlera: 2 010 euro.

Llogaritë si më sipër konfirmohen me të ardhura të ligjshme, sipas deklarimeve të subjektit nga “Raiffeisen Bank”, Vlorë⁴⁴.

Deklaratë e pasurisë së personit të lidhur.

Bashkëshortja e subjektit të rivlerësimit, znj. V. Z., ka plotësuar autorizimin për kontrollin e deklaratës së interesave, ku ka deklaruar se nuk disponon pasuri veçmas të regjistruar në emrin e saj. Pas verifikimeve u konstatua se ajo ka pasur një gjendje llogarie rrjedhëse në vlerën 45 000 lekë, me të ardhura nga paga në “Raiffeisen Bank”⁴⁵ (paga e dhjetorit), e cila nuk është deklaruar në deklaratën “Vetting” sipas detyrimit të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar.

Lidhur me mosdeklarimin e kësaj llogarie në deklaratën “Vetting”, në rezultatet e hetimit, subjektit i është kërkuar të japë sqarime. Në parashtrimet e tij, si dhe në seancën dëgjimore, subjekti ka sqaruar se ky mosdeklarim ka qenë për shkak të shumës së vogël të depozitës, e cila ka qenë një depozitë page, si dhe të situatës në të cilën ndodhej në momentin e plotësimit të deklaratës “Vetting”, periudhë gjatë të cilës ka pasur një vdekje në familje.

Në zbatim të nenit 3/11, të ligjit nr. 84/2016, si dhe të nenit 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar, subjekti i rivlerësimit ka pasur detyrimin të deklarojnë edhe vlerën e likuiditeteve në llogari rrjedhëse apo depozita bankare. Por, nisur nga vlera e ulët e depozitës me vlerë 45 000 lekë, si dhe fakti që ka qenë llogari page, Komisioni çmoi se pasaktësia në deklaratën “Vetting” është një pasaktësi formale për shkak të pakujdesisë dhe jo me qëllim fshehjeje të kësaj depozite dhe, si rrjedhim, nuk është konsideruar si deklarim i pamjaftueshëm.

Gjatë procesit të rivlerësimit u konstatua se të dy fëmijët e subjektit, në datën e dorëzimit të deklaratës “Vetting”, kanë qenë të mitur dhe si të tillë përjashtohen nga detyrimi për deklarim.

KONSTATIME TË TJERA

Me qëllim qartësimin e çdo situatë dhe heqjen e çdo dyshimi lidhur me disa fakte të konstatuara gjatë hetimit administrativ, janë kryer veprime hetimore në lidhje me sa vijojnë:

1. OSHEE-ja, në shkresën nr. *** prot., datë 31.1.2019, informon ndër të tjerash, se në emër të z. Kleanth Zeka rezultoi edhe kontrata me nr. *** në instancën Vlorë, me adresë ***, me datë hapjeje 16.7.2004.

Në përgjigjet e pyetësorit të parë, dërguar me *e-mail* në datën 21.1.2019, subjekti nuk e ka deklaruar këtë kontratë. Nga verifikimi në sistemin e gjendjes civile për vitin 2014 rezultojnë dy shtetas me emrin Kleanth Zeka, të dy nga Vlora : (i) shtetasi K. H. Z., i datëlindjes 1959 dhe (ii) subjekti Kleanth L. Zeka, i datëlindjes 1966. Lidhur me këtë, u pyet subjekti, i cili sqaroi⁴⁶ se kjo kontratë nuk i përket atij, pasi nuk ka asnjë pronë në fshatin ***, duke e vërtetuar këtë fakt me përgjigjen e OSHEE-së⁴⁷, e cila ka konfirmuar se kontrata me nr. ***, e cila furnizohet me energji nga kabina ***, i përket abonentit Kleanth H. Z..

⁴⁴ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 25.1.2019, të “Raiffeisen Bank”, në dosjen e Komisionit.

⁴⁵ Shihni shkresën nr. ***prot., datë 25.1.2019, të “Raiffeisen Bank”, në dosjen e Komisionit.

⁴⁶ Shihni përgjigjet e pyetësorit nr. 2 në dosjen e Komisionit.

⁴⁷ Shihni shkresën kthim-përgjigje nr. ***prot., datë 16.7.2019, nga OSHEE-ja, bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit nr. 2 në dosjen e Komisionit.

Në përfundim, nuk ka pasur asnjë dyshim në lidhje me një pasuri tjetër të mundshme në pronësi të subjektit apo familjareve të tij.

2. Për të hetuar mbi mundësinë e kontaktit me persona të papërshtatshëm, nga verifikimi i hyrje-daljeve në sistemin *TIMS*⁴⁸, nuk rezultoi që subjekti të ketë udhëtuar me automjete private. Duke qenë se vetëm në një rast rezultoi të ketë udhëtuar me autobus në mars të vitit 2011, për të cilin nuk ishin deklaruar shpenzime udhëtimi, për shkak se ka qenë jashtë periudhës së kërkuar në pyetësonin standard, subjekti u pyet specifikisht vetëm për këtë udhëtim, i cili sqaroi se⁴⁹: *...qëllimi i udhëtimit ka qenë për t'i bërë vizitë motrës së tij, znj. A. M., pasi bashkëshorti i saj vuante nga një sëmundje e rëndë terminale, me shpenzime minimale, konkretisht rreth 400 euro, pasi ka fjetur te banesa e së motrës...*

Nga verifikimi në sistemin *TIMS*, u vërtetua pretendimi i subjektit lidhur me faktin që motra e tij, znj. A. M., prej vitesh banon në shtetin grek. Lidhur me shpenzimet e deklaruara nga subjekti për tetë ditë qëndrimi në Greqi, në shumën 400 euro, Komisioni çmon se deklarimi i subjektit është i besueshëm, pasi ky shpenzimi i deklaruar është më i lartë se standardi i Komisionit⁵⁰ (shpenzim udhëtimi 80 x 3 = 240 euro dhe shpenzime qëndrimi 15 euro për tri persona x 8 ditë = 120 euro, në total 360 euro). Shpenzimet e këtij udhëtimi janë marrë në konsideratë gjatë analizës financiare, si shpenzime për vitin 2011.

3. Nga të dhënat bankare në datën 29.8.2008, në “Raiffeisen Bank”, u konstatua një kreditim në llogarinë e subjektit në shumën 700 000 lekë, me përshkrimin “kalim fondi, mbyllje dublikimi”, nga urdhëruesi B. A.

Subjektit iu kërkuar sqarime lidhur me qëllimin e këtij kreditimi, burimin e ligjshëm, si dhe marrëdhënien me shtetasen B. A., i cili deklaroi se⁵¹ *... nuk njeh dhe nuk ka hyrë në marrëdhënie financiare apo biznesi me ndonjë person me emrin B. A.... Në periudhën për të cilën bëhet fjalë ka pasur një depozitë në lekë në “Raiffeisen Bank”, si dhe llogarinë e pagës, por nuk ka kryer veprime të kësaj natyre...*

Për qartësimin e situatës lidhur me transfertën e datës 29.8.2008, subjekti i është drejtuar “Raiffeisen Bank”, dega Vlorë, e cila ka sqaruar se⁵² ky veprim ka qenë kalim midis llogarive nga vetë z. Kleanth Zeka dhe se znj. B. A. nuk ka lidhje me këtë transfertë, duke konfirmuar se të dhënat e saj janë mbartur gabimisht nga sistemi për shkak se numrin e llogarisë *** e ka pasur në përdorim z. Kleanth Zeka më parë në vitin 2008, ndërsa aktualisht e ka znj. B. A.. Znj. B. A. nuk ka qenë kliente në vitin 2008 dhe nuk ka kryer asnjë veprim në datën e mësipërme në llogaritë e z. Z.. Ajo ka qenë kliente e bankës në vitin 2015. Banka ka vënë në dispozicion lëvizjet e llogarive⁵³ të nxjerra nga sistemi i bankës në emër të z. Kleanth Zeka.

Për të hequr çdo dyshim në lidhje me këtë llogari bankare, Komisioni i rikërkoi informacion “Raiffeisen Bank”, e cila ka konfirmuar⁵⁴ se: (i) z. Kleanth Zeka ka pasur dy numra personalë: nr. *** (i cili është i hapur aktualisht) dhe nr. *** (i cili është mbyllur në vitin 2008), të cilin në vitin 2015 e ka marrë znj. B. A.; dhe (ii) për këtë shtetase janë mbartur

⁴⁸ Shihni shkresën nr. *** prot., datë 29.1.2019, të DPPSH-së, në dosjen e Komisionit.

⁴⁹ Shihni përgjigjet e pyetësorit nr. 3, dërguar nga subjekti në rrugë elektronike në datën 6.8.2019, në dosjen e Komisionit.

⁵⁰ Shihni vendimin e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. *** datë 22.05.2019

⁵¹ Shihni përgjigjet e pyetësorit nr. 3, dërguar nga subjekti në rrugë elektronike në datën 6.8.2019, në dosjen e Komisionit.

⁵² Shihni shkresën kthim-përgjigje nr. *** prot., datë 5.8.2019, nga “Raiffeisen Bank”, bashkëngjitur përgjigjeve të pyetësorit nr. 3, në dosjen e Komisionit.

⁵³ Shihni lëvizjet e llogarive bashkëlidhur shkresës së “Raiffeisen Bank”, në përgjigjet e pyetësorit nr. 3, në dosjen e Komisionit.

⁵⁴ Shihni shkresën kthim-përgjigje nr. *** prot., datë 12.9.2019, të “Raiffeisen Bank”, në dosjen e Komisionit.

gabimisht/automatikisht të dhënat nga sistemi, duke u reflektuar në llogarinë e z. Kleanth Zeka. Banka ka vënë në dispozicion CD me lëvizjet e llogarive për dy numrat e sipërcituar.

Në përfundim, Komisioni krijoi bindjen se kreditimi në shumën 700 000 lekë në llogari të subjektit nga shtetasja B. A., nuk ka pasur lidhje me subjektin e rivlerësimit.

4. Nga të dhënat bankare në “Raiffeisen Bank”⁵⁵ u konstatua se në datën 5.3.2010 subjekti ka derdhur në llogarinë e tij shumën 2 500 euro, ndërsa në datën 7.3.2011 ka derdhur shumën 3 000 euro. Nga analiza financiare deri në datat e këtyre derdhjeve, sipas tabelës më poshtë, rezulton se subjekti nuk ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për krijimin e tyre.

Data	Shuma e derdhur	Tërheqje 1.1.2010 - 5.3.2010	Shpenzim jetese 1.1.2010 - 5.3.2010	Tërheqje - shpenzim jetese (mundësia për kursim)	Diferenca e pajustificuar
5.3.2010	348.500	147.500	91.080	56.420	-292.080
7.3.2011	420.600	271.300	91.080	180.220	-240.380
					-532.460

Gjatë procesit të rivlerësimit subjektit iu kërkuan sqarime lidhur me burimin e këtyre shumave, i cili deklaroi se⁵⁶: ... në vitet 2010 dhe 2011 ka mbajtur gjendje *cash* në shtëpi të krijuara nga kursimet prej pagës së tij dhe bashkëshortes ndër vite për nevojat e përditshme, apo përballimin e ndonjë problemi shëndetësor. ...shumën prej 300 000 lekësh e konsideronte si një shumë të cilën nuk ndjente detyrimin për ta deklaruar gjatë deklarimeve periodike vjetore, me argumentin se ato nuk i përkisnin kursimeve të një viti të vetëm kalendarik, por edhe duke iu referuar ligjit lidhur me shpenzimet, ku shpenzime të kryera deri në një shumë të tillë nuk i nënshtroheshin deklarimit. ...mosdeklarimi i një shumë të tillë në fund të vitit, mund të jetë edhe rrjedhojë e padijenisë dhe e leximit jo të saktë të ligjit, duke vlerësuar së kjo sjellje nuk e ngarkonte me përgjegjësi...

Nga analiza financiare⁵⁷ ka rezultuar se subjekti ka pasur mundësi financiare me të ardhura të ligjshme për krijimin e shumës 2 500 euro në vitin 2009 dhe të shumës 3 000 euro në vitin 2010, të pretenduara si depozituara *cash* prej tij. Por, pavarësisht këtij fakti, në deklarimin për vitet 2009 dhe 2010, subjekti nuk ka deklaruar kursimet *cash* si më sipër, sipas detyrimit të germës “d”, të nenit 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar, dhe për këtë shkak, në rezultatet e hetimit administrativ, Komisioni ka konstatuar një diferencë të pajustificuar me të ardhura ligjore prej 532 460 lekësh në vitet 2010 dhe 2011.

Pas kalimit të barrës së provës lidhur me këtë konstatim, në parashtrimet e tij, ashtu sikurse dhe në seancën dëgjimore, subjekti ka dhënë të njëjtat sqarime si në përgjigjet e pyetësorit nr. 3, duke i konsideruar mosdeklarimet e gjendjeve *cash* si veprime të paqëllimshme. Subjekti parashtron se duke qenë se këto kursime janë me të ardhura të ligjshme të përfituara në vite, por edhe nisur nga vlera e vogël e tyre, duhet të vlerësohet në përputhje me parimin e proporcionalitetit.

Në përfundim të procesit, pasi ka shqyrtuar të gjitha provat dhe shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, Komisioni arriti në përfundimin se ka pasaktësi në deklaratat periodike vjetore për vitet 2009 dhe 2010, për shkak të mosdeklarimit të gjendjeve *cash*, përkatësisht në shumat 2500

⁵⁵ Shihni shkresën nr. ***, datë 25.1.2019, të “Raiffeisen Bank”, në dosjen e Komisionit.

⁵⁶ Shihni përgjigjet e pyetësorit nr. 3, dërguar nga subjekti në rrugë elektronike në datën 6.8.2019, në dosjen e Komisionit.

⁵⁷ Shihni tabelën 1 në këtë vendim.

euro dhe 3000 euro. Këto shuma nuk janë marrë në konsideratë gjatë analizës financiare përfundimtare, pikërisht për shkak të mosdeklarimit. Për këtë arsye, diferenca e pajustificuar në shumën 532 460 lekë për vitet 2010 dhe 2011, nuk ka ndryshuar.

Lidhur me peshën specifike të pasaktësive në deklaratat periodike të viteve 2010 dhe 2011 për shkak të mosdeklarimit të kursimeve *cash* si më sipër, duke mbajtur në konsideratë faktin se subjekti ka pasur mundësi financiare me të ardhura të ligjshme për krijimin e tyre, si dhe referuar argumenteve të paraqitura prej tij, Komisioni krijoi bindjen se mosdeklarimi i gjendjeve *cash* nuk është bërë me qëllim fshehje të ardhurash të paligjshme dhe si i tillë nuk ka sjellë asnjë pasojë, duke e çmuar këtë fakt si rrethanë lehtësuese gjatë procesit të vlerësimit përfundimtar të çështjes, lidhur me balancën negative prej 532 460 lekësh.

5. Gjatë hetimit administrativ është konstatuar se subjekti ka ndryshuar mbiemrin nga Zekaj në Zeka dhe emrin e babait nga L. në Th.. Pasi iu kërkuan shpjegime mbi kohën dhe qëllimin e këtyre ndryshimeve, subjekti ka dhënë sqarime dhe ka paraqitur dokumente⁵⁸ sipas të cilave:

- Ndryshimi i mbiemrit nga Zekaj në Zeka është bërë në vitin 2005, me qëllim përputhjen e dokumentacionit të rëndësishëm që dispononte me të dhënat e gjendjes civile. Sipas certifikatës personale datë 24.9.2019, lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile, Bashkia Vlorë, vërtetohet se ai ka ndryshuar ligjërisht mbiemrin nga Zekaj në Zeka.

- Ndryshimi i emrit të babait të tij nga L. në Th. është bërë prej babait të tij me kërkesë të motrës së tij të madhe A. (A.) M., emigrante në Greqi në vitin 2004. Me certifikatën familjare datë 24.9.2019, lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile Qendër, Bashkia Vlorë, vërtetohet se babai i subjektit ka ndryshuar ligjërisht emrin nga L. në Th..

Nisur nga të dhënat si më sipër, është kërkuar informacion në lidhje me pasuri të tjera të luajtshme apo të paluajtshme, si dhe të drejta reale të pronësisë mbi to, nga të gjitha institucionet ligjore, në emër të shtetasve Kleanth L. Zekaj dhe Kleanth Th. Zekaj (Zeka). Në përfundim të hetimit administrativ nuk kanë rezultuar të dhëna⁵⁹.

ANALIZË FINANCIARE

Gjatë hetimit administrativ është bërë një analizë e hollësishme financiare e pasurive të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të, bazuar në gjendjet e likuiditeteve, në të ardhurat e ligjshme, shpenzimet, detyrimet financiare, të deklaruara nga subjekti, duke i krahasuar me informacionet e marra në rrugë zyrtare nga institucionet kompetente ligjore. Kjo analizë është përmbledhur në tabelën 1, në të cilën pasqyrohen diferencat e pambuluara me të ardhura të ligjshme në momentin e krijimit të pasurive, në shumën prej 937 940 lekë, dhe në tabelën 2, ku pasqyrohet në mënyrë të përmbledhur analiza financiare për periudhën e rivlerësimit, 2003 – 2016.

Tabela nr. 1

Përshkrimi	2010	2011	2015	TOTAL
Diferenca negative për derdhjet e shumave 2 500 euro dhe 3 000 euro	-292.080	-240.380 ^[1]		-292.080
Diferenca negative për blerjen e njësisë në shumën 700 000 lekë		-485.584		-485.584
Diferenca negative e vitit 2015			-160.276	-160.276

⁵⁸ Shihni përgjigjet e datës 25.9.2019, në dosjen e Komisionit.

⁵⁹ Shihni përgjigjet e bankave, ASHK-së, OSHEE-së etj, në dosjen e Komisionit, me shkresa të dërguara pas datës 24.9.2019.

[1] Diferenca negative prej 240 380 lekësh për derdhjen në bankë të shumës 3 000 euro në vitin 2011 është e përfshirë në diferencën negative për blerjen e njësisë në shumën 485 584 lekë.

TOTALI	-292.080	-485.584	-160.276	-937.940
---------------	-----------------	-----------------	-----------------	-----------------

Tabela nr. 2

Përshkrimi	Pasuri	Detyrime	Pasuri neto	Të ardhura, dokumentuar	Shpenzime	Analiza dokumentuar
2003	56.975	0	56.975	739.125	281.892	400.258
2004	0	0	0	995.355	281.892	713.463
2005	158.709	0	158.709	1.154.632	328.671	667.252
2006	133.648	0	133.648	1.096.634	438.228	524.758
2007	67.155	0	67.155	1.258.037	546.480	644.402
2008	148.062	0	148.062	1.206.967	546.480	512.425
2009	366.797	0	366.797	1.617.158	546.480	703.881
2010	779.386	0	779.386	1.567.355	546.480	241.489
2011	1.471.737	0	1.471.737	1.678.947	601.800	-394.590
2012	955.639	0	955.639	1.718.276	558.192	204.445
2013	864.998	0	864.998	1.875.310	711.317	298.996
2014	1.850.270	840.660	1.009.610	2.113.582	879.992	223.980
2015	-49.441	-825.900	776.459	1.972.062	1.449.178	-253.575
2016	260.022	0	260.022	2.018.125	1.225.178	532.925
TOTAL	7.063.956	14.760	7.049.196	21.011.565	8.942.260	5.020.109

Lidhur me konstatimet si më sipër, sipas parashikimit të nenit 52, të ligjit nr. 84/2016, subjektit i kaloi barra e provës. Në parashtrimet e tij, si dhe në seancë dëgjimore, subjekti ka kundërshtuar disa nga gjetjet e Komisionit, si dhe ka dhënë shpjegimet përkatëse, bazuar në disa dokumente shkresore, mbi bazën e të cilave, në datën 7.11.2019 është përpiluar raporti i ekspertit kontabël të licencuar (auditues ligjor), z. A. M., sipas të cilit subjekti nuk rezulton me balancë negative të fondeve.

Përveç pretendimeve në lidhje me likuiditetet e pajustificuara, trajtuar dhe arsyetuar më sipër në këtë vendim, në parashtrimet e tij, subjekti ka kundërshtuar përfshirjen e shumës 338 309 lekë, si shpenzim në analizën financiare të Komisionit për vitin 2015, shumë të cilën ai e ka paguar si tatim mbi shitjen e pasurisë apartament banimi me sip. 100.8 m², ndodhur në lagjen “****”, Vlorë.

Lidhur me këtë pagesë nga aktet e paraqitura në ILDKPKI⁶⁰ dhe në dokumentet e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit⁶¹, ka rezultuar se:

- Me kontratën e shitblerjes datë 12.8.2015, z. Kleanth Zeka dhe znj. V. Z. kanë blerë nga shtetasit E. C. dhe K. C. apartament me sip 100.8 m², nr. pasurie ***, në shumën 37 000 euro.
- Me kërkesën e datës 24.8.2015, subjekti ka aplikuar në ZVRPP për pagimin e tatimit mbi shitjen dhe me pasqyrën llogaritëse të tatimit për kalimin e së drejtës së pronësisë datë 24.8.2015, kjo shumë është llogaritur 331 309 lekë.
- Shuma e tatimit është paguar sipas një mandatarkëtimi, në të cilën data është e padëshifrueshme, me emër depozituesi z. Kleanth Zeka.

⁶⁰ Shihni aneksin 28 në dosjen e ILDKPKI-së.

⁶¹ Shihni parashtrimet e datës 13.11.2019, në dosjen e Komisionit.

Në sqarimet e tij, subjekti pranon se pagesa është kryer formalisht prej tij, por për llogari të shitësit K.C. dhe me të ardhura të tij, pasi shuma prej 331 309 lekësh i është dhënë nga ky shtetas dorazi ditën e pagesës, datë 24.8.2015. Për të vërtetuar këtë fakt, subjekti ka depozituar tërheqje *cash* në shumën 3 000 euro, prej z. K. C., në datën 24.8.2015. Gjithashtu, sipas tij, detyrimi ligjor për pagesën e tatimit mbi shitjen i takon këtij shtetasi, me cilësinë e shitësit të pasurisë, ashtu sikurse është përcaktuar në kontratën e shitjes së pasurisë dhe, si rrjedhim, gabimisht kjo shumë është llogaritur si shpenzim për vitin 2015.

Lidhur me këtë pretendim të subjektit, Komisioni çmon se konferma bankare me titull “tërheqje *cash* në valutë” në datën 24.8.2015, të shumës 3 000 euro nga shitësi shtetasi K. C., si dhe kontrata e shitjes datë 3.6.2014, të sendit të ardhshëm (sipas pikës 5.4 të të cilës detyrimi për transferimin e titullit të pronësisë do të paguhet nga shitësi), nuk janë prova që të vërtetojnë pretendimin që pagesa e tatimit mbi shitjen është bërë nga shtetasi K. C. Ndërkohë, është vërtetuar me dokument shkresor, që kjo pagesë është bërë nga subjekti i rivlerësimit, i cili nga ana e vet e pranon këtë fakt. Si rrjedhim, shuma prej 331 309 lekësh, gjatë analizës financiare për vitin 2015, është vlerësuar të konsiderohet si shpenzim i kryer nga subjekti i rivlerësimit.

Në përfundim të vlerësimit për analizën financiare, subjekti nuk arriti të vërtetojë të kundërtën e konstatimit se balanca negative për të gjithë periudhën e rivlerësimit është në shumën 937 940 lekë.

Metodologjia e përdorur nga Komisioni për analizën financiare.

Gjatë kësaj analize, Komisioni është bazuar në:

a. Gjendjet e likuiditeteve të subjektit dhe personave të lidhur, të nxjerra nga dokumentet bankare nga: Raiffeisen Bank⁶², BKT⁶³ dhe Banka e Pare e Investimeve⁶⁴.

b. Të ardhurat e ligjshme, ku përfshihen:

(i) Të ardhurat nga pagat e subjektit në: Prokurorinë e Rrethit Vlorë⁶⁵

(ii) Të ardhurat nga pagat e bashkëshortes: si mësuese në Vlorë⁶⁶, si mësuese në shkollën ***⁶⁷, mësuese në ***⁶⁸, të ardhura nga leja e lindjes⁶⁹,

(iii) Të ardhura nga interesa bankare⁷⁰

(iv) Të ardhura nga qiraja⁷¹

c. Shpenzimet, ku përfshihen: (i) Shpenzimet e jetesës bazuar në shpenzimet mujore për konsum sipas madhësisë së njef, (anketa e buxhetit të familjes nga INSTAT)⁷²; (ii) Shpenzime udhëtimi për të cilat janë marrë të dhëna nga sistemi TIMS. Për përllogaritjen e shpenzimeve të udhëtimit janë marrë si bazë shpenzimet mesatare të udhëtimeve sipas linjave ajrore, duke filluar nga 180 euro për udhëtim deri në 300 euro për udhëtim për linjat më të gjata. Në rastet

⁶² Shkresa nr. *** prot., dt. 25/01/2019 nga RFZ Bank

⁶³ Shkresa nr. *** prot., dt. 29/01/2019 nga BKT

⁶⁴ shkresa nr. *** prot., dt. 31/01/2019 nga FIB

⁶⁵ Vërtetim nr. *** prot., dt. 27/10/2016 nga Prokuroria Rrethit Vlorë

⁶⁶ Vërtetim nr. *** prot., dt. 24/10/2016 nga DAR

⁶⁷ Vërtetim nr. *** prot., dt. 23/01/2017 Shkolla ***

⁶⁸ Vërtetim nr. *** prot., dt. 24/10/2016 DAR

⁶⁹ Vërtetim nr. *** prot., dt. 25/10/2016 ISSH

⁷⁰ Shkresa nr. *** prot., dt. 25/01/2019 nga RFZ Bank

⁷¹ Kontrate qiraje nr. *** ,dt. 11/01/2013 midis Kleanthi Zeka dhe A. S. dhe shkresa nga DRT Vlore nr. ***prot., dt 04/09/2019 tek përgjigjet e pyetesorit.

⁷² Shih vendimin nr. 02 datë 22.06.2018, bashkangjitur tabela për shpenzimet mujore për konsum, në dosjen e KPK-së.

kur ka informacion për destinacionet e largëta, shpenzimet e udhëtimit janë llogaritur, duke parë në internet çmimet mesatare të destinacionit përkatës. Ndërsa për shpenzimet e qëndrimit janë llogaritur 50 euro/ditë shpenzim qëndrimi dhe ushqimi. Në rastet kur është deklaruar qëndrim tek familjarët shpenzimet e qëndrimit janë llogaritur 5 euro/ditë. Në rast se shpenzimet e udhëtimit të deklaruara nga subjekti kanë qenë më të larta se ato të llogaritura nga Komisioni, shpenzimet e udhëtimit janë vendosur sa ato të deklaruara. (iii) Shpenzime arredimi dhe shkollimi të deklaruara nga subjekti në pyetësorët e dërguar nga KPK.⁷³

II.2 VLERËSIMI I FIGURËS

DSIK-ja, me shkresën nr. *** prot., datë 2.11.2017, ka dërguar raportin mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, z. Kleanth L. Zeka, i deklasifikuar plotësisht me vendim nr. ***, datë 18.7.2019, të KDZH-së, i cili konstaton se:

- formulari i deklarimit është i plotë, i plotësuar në mënyrë të saktë në përputhje me ligjin nr. 84/2016;
- grupi i punës konstaton përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit.

A. Në lidhje me plotësimin e formularit të deklarimit:

Nga verifikimi i formularit të vetëdeklarimit “Për zbatimin e ligjit nr. 138/2015, ‘Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike’”, të subjektit të rivlerësimit, rezultoi se në rubrikën e mëparshme gjeneralitete subjekti ka deklaruar ndryshimin e emrit nga Zekaj në Zeka dhe atësinë nga L. në Th..

Subjekti, pasi iu kërkuan shpjegime mbi kohën dhe qëllimin e këtyre ndryshimeve, ka dhënë sqarime dhe ka paraqitur dokumente⁷⁴, sipas të cilave:

- Ndryshimi i mbiemrit nga Zekaj në Zeka është bërë ligjërisht në vitin 2005, në mënyrën që është përshkrua sa sipër në këtë vendim, dhe me qëllim përputhjen e mbiemrit në dokumentat që dispononte me aktet e gjëndjes civile.
- Ndryshimi i emrit të babait të tij nga L. në Th. është bërë ligjërisht prej babait të tij, me kërkesë të motrës së tij të madhe A. (A.) M., emigrante në Greqi që prej vitit 2004, në mënyrën që është përshkruar sa sipër në këtë vendim. Sipas subjektit, ky ndryshim është bërë për shkak se motra e tij A. (A.) M. ka deklaruar në shtetin grek emrin e babait Th., dhe i nevojitej ndryshimi i emrit të babait nga L. në Th., për efekt dokumentacioni, praktikë e aplikuar shpesh nga emigrantët shqiptarë në këtë shtet.

Nga sa më sipër, rezultoi se subjekti ka pasur emrin Kleanth Zekaj, të cilin e ka ndryshuar në Kleanth Zeka, ndërkohë që, gjatë plotësimit të formularit për kontrollin e figurës, pyetjes: *Nëse keni pasur emër tjetër më parë?*, subjekti i është përgjigjur me “jo”. Pra, deklarata për kontrollin e figurës, sipas shtojcës nr. 3, të ligjit nr. 84/2016, nuk është plotësuar në mënyrë të saktë nga subjekti i rivlerësimit.

Subjekti, pasi u njoh me konstatimin sa më sipër, në parashtrimet e tij, por edhe në seancën dëgjimore, deklaroi se e gjen atë të drejtë, pasi nuk ka deklaruar ndërhyrjen në mbiemrin që mbante, nga Zekaj në Zeka. Ai ka deklaruar se një veprim i tillë nuk ka qenë i qëllimshëm, duke menduar se mbiemër tjetër do të thoshte mbajtja e një mbiemri të ndryshëm nga ai që kishte në periudhën e deklarimit, ndërkohë që kishte hequr vetëm një germë nga mbiemri.

⁷³ Nr. *** prot., dt. 28/01/2019 Alpha Bank

⁷⁴ Shihni përgjigjet e datës 25.9.2019, në dosjen e Komisionit.

Për të verifikuar nëse mosdeklarimi i ndryshimit të emrit në deklaratën për kontrollin e figurës është bërë nga subjekti me qëllim fshehjen e të dhënave lidhur me figurën e tij, apo fshehjen e ndonjë pasurie të padeklaruar më parë prej tij, Komisionit i kërkoi DSIK-së informacion për figurën e subjektit, me gjeneralitet **Kleanth L. Zekaj** dhe **Kleanth Th. Zeka (Zekaj)**, si dhe u bënë kërkime për pasuri tjera dhe të drejta reale të pronësisë, të padeklaruar nga subjekti me këto gjeneralitete.

Nga përgjigjet konfidenciale të agjencive ligjzbatuese nuk rezultuan të dhëna lidhur me figurën e subjektit të rivlerësimit, me gjeneralitetet e sipërpërmendura. Gjithashtu, nga institucionet kompetente ligjore nuk rezultuan pasuri të çdo lloji në emër të subjektit me këto gjeneralitete. Në lidhje me emrin e babait, pas verifikimeve në regjistrat e gjendjes civile dhe nga të gjitha aktet e gjendjes civile të administruara gjatë procesit të rivlerësimit, rezulton që atësia e subjektit është L.. Pra, në këto akte nuk është pasqyruar asnjëherë ndryshimi i emrit të babait të tij nga L. në Th., çka tregon që ky ndryshim është kryer formalisht për shkaqet e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit.

Në procesin e vlerësimit përfundimtar të çështjes, Komisioni çmoi se pasaktësia në plotësimin e deklaratës për kontrollin e figurës sipas shtojcës nr. 3, të ligjit nr. 84/2016, është një pasaktësi formale dhe si e tillë nuk mund të konsiderohet si shkak për marrjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra të subjektit të rivlerësimit, sipas parashikimit të nenit DH/4 të Kushtetutës, për shkak se:

- i. Nuk ka qenë me qëllim fshehjen e kontakteve të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar;
- ii. Nuk ka qenë me qëllim fshehjen e ndonjë pasurie apo cilësdo të drejta reale të pronësisë, parashikuar nga dispozitat e Kodit Civil në Republikën e Shqipërisë;
- iii. Komisioni konsideron si rrethanë lehtësuese ndryshimin e mbiemrit vetëm për shkak të heqjes së germës “j” në fund të tij, i cili nuk ka pasqyruar ndryshimin në thelb të emrit të subjektit të rivlerësimit.

B. Në lidhje me përshtatshmërinë për vijimin e ushtrimit të detyrës:

Gjatë hetimit administrativ nuk ka pasur të dhëna, informacione dhe dyshime për kontakte të papërshtatshme të subjektit me persona të përfshirë në krimin e organizuar, apo veprimtari korruptive nga ana e tij.

Bazuar në sa më sipër, Komisioni krijoi bindjen se përfundimi i arritur nga DSIK-ja, në lidhje me vlerësimin e figurës së subjektit të rivlerësimit, është i bazuar, dhe rrjedhimisht z. Kleanth Zeka, është i përshtatshëm për vijimin e ushtrimit të detyrës.

II.3 VLERËSIMI PROFESIONAL

Në zbatim të nenit 44, të ligjit nr. 84/2016, është bërë rivlerësimi profesional i subjektit të rivlerësimit, z. Kleanth Zeka, bazuar në:

A. Raportin nr. *** prot., datë 25.7.2019, për analizimin e aftësisë profesionale të subjektit të rivlerësimit, të kryer nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë, protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 30.7.2019, sipas të cilit subjekti është vlerësuar pozitivisht dhe është konstatuar si vijon, në lidhje me:

1. Aftësitë profesionale:

a) Njohuritë ligjore

Nga analiza e tri dokumenteve ligjore të paraqitura nga vetë subjekti i rivlerësimit dhe vëzhgimi i pesë dosjeve gjyqësore të shortuara, rezulton se prokurori Kleanth Zeka shfaq aftësi në kuptimin dhe interpretimin e drejtë të legjislacionit në fuqi, duke bërë një analizë të qartë të dispozitave ligjore.

b) Arsytimi ligjor

Subjekti i rivlerësimit, z. Kleanth Zeka, shfaq aftësi shumë të mira në arsyetim ligjor, duke marrë vendime dhe përpiluar akte procedurale shumë cilësore.

2. Aftësitë organizative:

a) Aftësia për të përballuar ngarkesën në punë

Subjekti i rivlerësimit, z. Kleanth Zeka, në periudhën e rivlerësimit 8.10.2013 – 8.10.2016, ka kryer detyrën e prokurorit të Prokurorisë së Apelit Vlorë, duke trajtuar dhe përfunduar gjithsej 1006 çështje të objekteve të ndryshme. Ky numër çështjesh të përfunduara, të cilat përbëjnë ngarkesë të konsiderueshme, tregon për një organizim shumë të mirë të ngarkesës së punës.

b) Aftësia për të kryer procedurat gjyqësore

Nga analiza e tri dokumenteve ligjore të paraqitura nga vetë subjekti i rivlerësimit dhe vëzhgimi i pesë dosjeve gjyqësore të shortuara, evidentohet se subjekti i rivlerësimit është i aftë profesionalisht në pjesëmarrjen në gjykim dhe për qëndrimin që mban për çështjet në gjykim.

c) Aftësia për të administruar dosjet

Dosjet e vëzhguara janë të rregullta, të plota dhe aktet procedurale të përpiluara janë të sakta, të strukturuar, në respektim të normave të drejtshkrimit.

3. Etika dhe angazhimi ndaj vlerave profesionale:

a) Etika në punë

Nga aktet e përzgjedhura nga vetë subjekti, si dhe nga dosjet e hedhura në short, ka rezultuar se gjuha e përdorur nga subjekti i rivlerësimit në përpilimin e akteve është në përputhje me etikën profesionale të prokurorit. Për periudhën e rivlerësimit tetor 2013 – tetor 2016, për subjektin e rivlerësimit, prokurori Kleanth Zeka nuk është marrë asnjë masë disiplinore. Komunikimi, bashkëpunimi, sjellja ndaj eprorëve, kolegëve, vartësve dhe administratën, ka qenë korrekte duke respektuar dinjitetin dhe personalitetin e tyre.

b) Integriteti

Nga të dhënat e deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, z. Kleanth Zeka, dhe nga pesë dosjet e vëzhguara, konstatohet se nuk kanë dalë të dhëna në lidhje me imunitetin e tij ndaj çdo ndikimi apo presioni të jashtëm.

c) Paanësia

Nuk janë evidentuar raste të konfliktit të interesit të subjektit të rivlerësimit, prokurorit Kleanth Zeka. Në asnjë prej pesë dosjeve të vëzhguara nuk ka të dhëna që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit. Nuk është konstatuar përdorim i gjuhës diskriminuese apo elemente të tjera që të vënë në dyshim paanësinë e subjektit të rivlerësimit. Nuk janë konstatuar raste që subjekti i rivlerësimit, prokurori Kleanth Zeka, të ketë cenuar të drejtat e palëve dhe të viktimave.

4. Aftësitë personale dhe angazhimi profesional:

a) Aftësitë e komunikimit

Nga tri dokumentet ligjore të vetëpërzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit dhe pesë dosjet e rëna në short, vihet re se komunikimi është në përputhje me etikën e prokurorit dhe i qartë.

b) Aftësia për të bashkëpunuar

Në tri dokumentet ligjore dhe në pesë dosjet e vëzhguara nuk janë konstatuar të dhëna specifike mbi aftësinë e subjektit të rivlerësimit, prokurorit Kleanth Zeka, për të bashkëpunuar me kolegët dhe administratën e prokurorisë, si dhe nëse subjekti ka shkëmbyer njohuri apo përvojë profesionale me ta.

c) Gatishmëria për t'u angazhuar

Subjekti i rivlerësimit, për periudhën e rivlerësimit, nuk ka ndjekur trajnime të Shkollës së Magjistraturës, por ka pasur disa trajnime për vitet e mëparshme pranë kësaj shkolle.

B. Informacionin e marrë nga burime të ligjshme, ku si të tilla janë konsideruar:

1. Tre vendimet e përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit dhe pesë çështjet e shortuara sipas nenit 43, të ligjit nr. 84/2016, nga analiza e të cilave rezultuan të njëjtat konstatime si ato të Këshillit të Lartë të Prokurorisë në raportin e saj.

2. Në Komision është administruar 1 denoncim nga publiku, si vijon:

Denoncimi i shtetasit T. S.⁷⁵, i cili ankohet se në një rast z. Kleanth Zeka, ka hequr dorë nga ankimi në mënyrë të padrejtë dhe të kundërligjshme, duke mos vlerësuar faktet dhe provat e listuara nga organi që ai përfaqëson.

Kjo ankesë është trajtuar më parë edhe nga Drejtoria Gjyqësore në Prokurorinë e Përgjithshme,⁷⁶ e cila, pasi ka analizuar vendimin për heqjen dorë nga ankimi, të marrë nga prokurori Kleanth Zeka, ka vlerësuar se vendimmarrja ka qenë në përputhje me nenet 25/3, 408/2 dhe 418/1/2 të Kodit të Procedurës Penale, ligjin “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, si dhe udhëzimet e Prokurorit të Përgjithshëm që normojnë këtë aspekt të veprimtarisë së prokurorit në gjykim.

Gjatë hetimit administrativ, pasi janë marrë në shqyrtim aktet e vëna në dispozicion nga denoncuesi, Komisioni vlerësoi se subjekti i rivlerësimit ka ushtruar të drejtën e heqjes dorë nga ankimi, në përputhje me nenin 418 të Kodit të Procedurës Penale, sipas të cilit: “Prokurori që ka bërë ankimin mund të heqë dorë prej tij deri në fillimin e shqyrtimit gjyqësor, ndërsa heqja dorë nga prokurori pranë gjykatës që shqyrton ankimin mund të bëhet deri para fillimit të diskutimit përfundimtar”.

3. Informacionin e marrë nga KLP-ja, në lidhje me ankesa dhe procedime disiplinore të subjektit të rivlerësimit.

Sipas këtij informacioni, për subjektin rezultoi ankesa nr. ***, e vitit 2018, e shtetasit I. Gj., i cili ka pasur një material kallëzues që në vitin 2011, ku prokuror i çështjes ka qenë prokurori Kleanth Zeka. Në këtë rast subjekti ka marrë vendimin për mosfillimin e procedimit penal, vendim i cili është konsideruar i padrejtë nga ankuesi. Kjo ankesë është arkivuar në datën 17.8.2018.

Me kërkesë të Komisionit, Prokuroria e Përgjithshme vuri në dispozicion dosjen e kallëzimit penal nr. 86.2011, të shtetasit I. Gj., me akuzën për shkatërrim prone⁷⁷, për të cilin prokurori

⁷⁵ Shihni ankim nga z. T. S., të protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 27.12.2018, në dosjen e Komisionit dhe dokumentet bashkëngjitur.

⁷⁶ Shihni shkresën nr. ***prot., (S. S.), datë 25.2.2015, të Prokurorisë së Përgjithshme, drejtuar shtetasit T. S., bashkëngjitur shkresës kthim-përgjigje nr. *** prot., datë 16.7.2019, nga Prokuroria e Përgjithshme, në dosjen e Komisionit.

⁷⁷ Shihni shkresën kthim-përgjigje nr. ***prot., datë 3.10.2019, nga Prokuroria e Përgjithshme, në dosjen e Komisionit.

Kleanth Zeka ka vendosur mosfillimin e çështjes. Nga verifikimi i akteve të dosjes dhe hapave procedurale të ndjekura nga subjekti, nuk rezultuan shkelje ligjore, si rrjedhim, pretendimi i ankuesit ka qenë i pabazuar, fakt që ka sjellë edhe arkivimin e ankesës.

C. Rivlerësimi profesional sipas kriterëve të parashikuara në nenin 71 e vijues të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

Në përfundim të procesit të rivlerësimit të aftësive profesionale, sipas kriterëve të parashikuara në kreun II, të ligjit nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, rezultoi se:

- Subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi të mira profesionale, sipas nenit 73, të ligjit nr. 96/2016.
- Subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi të mira organizative, sipas nenit 74, të ligjit nr. 96/2016.
- Subjekti i rivlerësimit ka treguar aftësi personale dhe angazhim profesional, sipas nenit 76 të ligjit nr. 96/2016.
- Në lidhje me etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale, parashikuar nga neni 75 i ligjit nr. 96/2016, gjatë procesit të rivlerësimit profesional u kryen hetime lidhur me konfliktin e interesit gjatë ushtrimit të detyrës me shtetasit K. C. (shitës i pasurisë apartament banimi në Vlorë) dhe L. C., babai i tij, si vijojnë:

Në përgjigjet e pyetësorit nr. 2, subjekti ka deklaruar dhe ka vërtetuar katër raste të konfliktit të interesit me shtetasit K. dhe L. C., për shkak të njohjeve me ta, duke dhënë dorëheqjen nga marrja pjesë si përfaqësues i organit të akuzës në kolegjet përkatëse të Gjykatës së Apelit Vlorë.

Me qëllim evidentimin e konfliktit të interesit janë administruar katër deklaratat të dorëheqjeve të subjektit⁷⁸, si dhe katër kopje të vendimeve të drejtuesit të prokurorisë për pranimin e dorëheqjeve dhe zëvendësimin e tij⁷⁹.

Nga shqyrtimi i këtyre akteve ka rezultuar se:

a. Në datën 5.12.2016, prokurori Kleanth Zeka ka dhënë dorëheqjen nga përfaqësimi i akuzës pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, për çështjen penale me të pandehur K. C., akuzuar për veprën penale “goditje për shkak të detyrës”. Shorti për këtë çështje është hedhur në datën 5.9.2016, vërtetuar me urdhrin nr. ***, datë 5.9.2016, të Drejtuesit të Prokurorisë pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, dhe me procesverbalin e kësaj date për organizimin e shortit, sipas të cilit subjekti është caktuar për përfaqësimin e prokurorisë pranë kolegjit gjyqësor përkatës.

b. Në datën 19.2.2018, prokurori Kleanth Zeka ka dhënë dorëheqjen nga përfaqësimi i akuzës në gjykim pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, për çështjen penale me të pandehur L. C., akuzuar për kryerjen e veprës penale “kallëzim i rremë”.

c. Në datën 7.5.2018, prokurori Kleanth Zeka ka dhënë dorëheqjen nga përfaqësimi i akuzës në gjykim pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, për çështjen penale me të pandehur K. dhe L. C. (nuk evidentohet akuza).

⁷⁸ Shihni deklaratat e heqjes dorë të datave 5.12.2016, 19.2.2018, 8.5.2019, bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit nr. 2, protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 22.07.2019, dhe deklaratën datë 7.5.2018, e heqjes dorë nga funksioni, bashkëngjitur përgjigjeve të datës 13.9.2019 në dosjen e Komisionit.

⁷⁹ Shihni vendimet e zëvendësimit të prokurorit të datave 5.12.2016, 19.2.2018, 7.5.2018 dhe 8.5.2019, bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit nr. 2, protokolluar nga Komisioni me nr. *** prot., datë 22.7.2019, në dosjen e Komisionit.

Për të dyja këto çështje (ne piken “b” dhe “c” me siper) u vërtetua se me urdhrin nr. ***, datë 14.2.2018, të drejtuesit të Prokurorisë së Apelit Vlorë, po në këtë datë, është hedhur shorti dhe është caktuar subjekti për përfaqësimin e prokurorisë pranë kolegjit gjyqësor përkatës.

d. Në datën 8.5.2019, prokurori Kleanth Zeka ka dhënë dorëheqjen nga përfaqësimi i akuzës pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, për çështjen penale në të cilën shtetasi K. C. ka qenë avokat i të pandehurit. Me urdhrin nr. ***, datë 10.1.2019, të Drejtuesit të Prokurorisë së Apelit Vlorë, po në këtë datë është hedhur shorti dhe është caktuar subjekti për përfaqësimin e prokurorisë pranë kolegjit gjyqësor përkatës.

Lidhur me konfliktin e mundshëm të interesit, u vërtetua se në të katër çështjet ku pjesëmarrës në hetime kanë qenë shitësi i pasurisë apartament banimi me sip. 100.8 m², shtetasi K. C. dhe babai i tij L. C., subjekti ka dhënë dorëheqjen nga shqyrtimi i çështjeve për shkak të njohjes së hershme me këta shtetas, duke ushtruar detyrën, në përmbushje të detyrimeve ligjore në nenet 17 dhe 26 të Kodit të Procedurës Penale.

Por, sipas provave të sipërpërmendura, u konstatua se dorëheqja është dhënë në një rast brenda tri ditëve nga data që është hedhur shorti, ndërkohë që, në tri raste të tjera dorëheqja është dhënë brenda një afati 3-4 muaj pasi është hedhur shorti.

Lidhur me këtë konstatim, në parashtrimet e tij⁸⁰, por dhe në seancën dëgjimore, subjekti ka sqaruar: *... në arritjen e këtij konstatimi, Komisioni i është referuar urdhrave të nxjerra nga Drejtuesi i Prokurorisë së Apelit Vlorë për organizimin e shortit për ndarjen e kolegjeve gjyqësore, short i cili nuk është një short individual ...pas atij shorti çdo prokuror do të duhet të punojë me një koleg gjyqësor të caktuar, por kjo nuk nënkupton se nga ai moment prokurori ka marrë dijeni se cilat do të jenë çështjet që ai do të përfaqësojë në vijimësi në gjykim... dijenia e prokurorit për një çështje penale konkrete materializohet vetëm pasi gjyqtari relator të cilit i ka rënë çështja, cakton datën e gjykimit... kontaktin e parë fizik me dosjen prokurori e realizon vetëm mbas tërheqjes së tyre prej sekretarisë së Prokurorisë së Apelit Vlorë, gjë që ndodh rreth një javë përpara datës së gjykimit. Ky është edhe momenti kur çdo prokuror ka mundësi të verifikojë shkaqet e mundshme të papajtueshmërisë me detyrën...*

Në shqyrtimin tërësor të çështjes, referuar edhe dispozitave të Kodit të Procedurave Penale, i cili në asnjë rast nuk parashikon ndonjë afat të marrjes dijeni së prokurorit të apelit mbi çështjen konkrete, Komisioni vlerësoi bindëse shpjegimet e subjektit sipas të cilave, marrja dijeni e prokurorit të apelit për çështjen, është në varësi të caktimit të datës së gjykimit nga gjyqtari relator dhe jo nga data e hedhjes së shortit. Si rrjedhim, dorëheqja e tij për shkak të konfliktit të interesit me shtetasit K. C. dhe babanë e tij L. C., brenda një periudhe 3-4 muaj, nuk qenë në kundërshtim me ligjin dhe etikën e prokurorit.

Në përfundim, sipas germës “a”, të nenit 44, të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit, pas propozimit të relatores së çështjes, është vlerësuar “i aftë” profesionalisht, për shkak se ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve ose viktimave, si dhe është eficient dhe efektiv në masë të pranueshme në punë, e si rrjedhim ka arritur nivelin kualifikues për vlerësimin e aftësive profesionale.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

⁸⁰ Shihni shpjegimet për rezultatet e hetimit, dërguar nga subjekti në rrugë elektronike në datën 13.11.2019, në dosjen e Komisionit.

Gjatë procesit të rivlerësimit, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave, si dhe krijimin e bindjes së brendshme, trupi gjykues ka komunikuar me anë të postës elektronike me subjektin e rivlerësimit, sipas nenit 46, të ligjit nr. 84/2016 gjatë procesit të rivlerësimit, si dhe në mënyrë të drejtpërdrejtë gjatë seancës dëgjimore, ku subjekti ishte prezent, pa praninë e ndonjë përfaqësuesi ligjor.

Në të gjitha komunikimet, subjekti ka qenë i gatshëm, duke u treguar tërësisht bashkëpunues, pasi i është përgjigjur me korrektesë brenda afateve të caktuara të gjitha pyetjeve, duke dhënë në mënyrë shteruese informacionin e kërkuar, gjë që është mbajtur në konsideratë në marrjen e vendimit, në përputhje me nenin 48, të ligjit nr. 84/2016.

IV. SEANCA DËGJIMORE

Në datën 20.11.2019, sipas nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, u zhvillua seanca dëgjimore për procedurën e rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit, z. Kleanth Zeka, gjatë së cilës kërkoi konfirmimin në detyrë.

Trupi gjykues i Komisionit, nisur nga rezultatet e hetimit administrativ lidhur me pasurinë, figurën dhe aftësitë profesionale, vlerësoi se procesi i vendimmarrjes në përfundim të procesit të rivlerësimit kalimtar të subjektit të rivlerësimit, z. Kleanth Zeka, duhet të bazohet në vlerësimin tërësor të tri kriterëve, referuar pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016.

Në përfundim të seancës dëgjimore, trupi gjykues i Komisionit, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, komisionere Firdes Shuli, e cila rekomandoi konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, dëgjoi subjektin, i cili kërkoi konfirmimin në detyrë dhe pasi administroi dokumentet shkresore, përfundoi procedurën e rivlerësimit kalimtar për subjektin e rivlerësimit, z. Kleanth Zeka, dhe shpall këtë vendim sot, në datën 22.11.2019, sipas pikës 6, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.

V. VLERËSIMI TËRËSOR I ÇËSHTJES

Përpos konstatimeve të rezultuara në përfundim të procesit të rivlerësimit për të tria kriteret si më sipër, gjatë procesit të vendimmarrjes, Komisioni është bazuar në një vlerësim të përgjithshëm të rrethanave për të tria kriteret, sipas parashikimit të pikës 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, referuar edhe fakteve si vijojnë:

- Gjatë gjithë periudhës së rivlerësimit, subjekti i rivlerësimit ka kaluar vetëm në një rast kufirin me Shqipërinë, duke udhëtuar në shtetin grek me bashkëshorten dhe një prej fëmijëve me autobus, fakt që tregon se ka qenë i rezervuar në shpenzimet e tij.
- Në adresë të subjektit të rivlerësimit ka pasur vetëm një denoncim nga publiku, një tregues se perceptimi i tij për këtë subjekt është pozitiv dhe ai gëzon besimin e publikut.
- Ligji nr. 84/2016, si dhe Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e konsideron procesin e rivlerësimit kalimtar të subjekteve të rivlerësimit si një proces të bazuar jo vetëm në detyrimin formal të subjekteve për të deklaruar me vërtetësi dhe saktësi të dhëna në lidhje me tri kriteret e parashikuara nga ligji, por edhe në qëndrimin që ata mbajnë në raport me gjithë procedurat e rivlerësimit, i cili duhet të reflektojë integritet, si dhe të dëshmojë vërtetësi dhe transparencë në çdo deklaram, në funksion të forcimit të besimit të publikut te institucionet e sistemit të drejtësisë, qëndrim i cili është konstatuar në rastin e subjektit të rivlerësimit, z. Kleanth Zeka.
- Pavarësisht pasaktësive të konstatuara, subjekti ka qenë tepër i saktë dhe i detajuar në plotësimin deklaratave periodike vjetore, si dhe ka dhënë shpjegime të hollësishme për

parregullsitë e konstatuara, duke mbajtur qëndrim reflektues dhe ka pranuar se në disa raste ka qenë i pakujdesshmen në plotësimin e deklaratave vjetore, duke argumentuar në çdo rast paqartësitë e tij.

- Shuma prej 532 460 lekësh, e konsideruar si balancë negative gjatë analizës financiare, ka ardhur për shkak të mosdeklarimit të likuiditeteve *cash* në vitet 2009 dhe 2010, të cilat subjekti kishte mundësi t'i krijonte me të ardhura të ligjshme.

VI. KONKLuzion Përfundimtar

Bazuar në parimet e barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, si dhe parimin e proporcionalitetit, sipas nenit 4 pika 5 e ligjit nr.84/2016, në përfundim të procesit të rivlerësimit, Komisioni krijoi bindjen se :

1. Referuar nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut IV, të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pasurisë, subjekti i rivlerësimit, z. Kleanth Zeka, ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas nenit 59/a të ligjit.
2. Referuar nenit DH, të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut V, të ligjit nr. 84/2016, lidhur me kriterin e pastërtisë së figurës, subjekti i rivlerësimit, z. Kleanth Zeka, ka arritur nivel të besueshëm për kontrollin e figurës, sipas nenit 59/b të ligjit.
3. Referuar nenit E, të Aneksit të Kushtetutës dhe kreut VI, të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit, z. Kleanth Zeka, ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas nenit 59/c të ligjit.

PËR KËTO ARSYE

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi kreu bisedimet për marrjen e vendimit në praninë edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, sipas parashikimit pikës 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, bazuar në germën “a”, të pikës 1, të nenit 58, në pikën 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, si dhe në Aneksin e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë,

V E N D O S I

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, z. Kleanth Zeka, me detyrë prokuror në Prokurorinë e Apelit Vlorë.
2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë brenda 30 ditëve pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 22.11.2019.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Kryesues
Etleda ÇIFTJA

Anëtar/Relator
Firdes SHULI

Anëtar
Roland ILIA

Sekretare gjyqësore
Anisa Duka